



Projekt i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Project of the Kosovo Foundation for Open Society  
Projekat Kosovske Fondacije za Otvoreno Društvo

# zōj idhje

A Garanton Kushtetuta e Kosovës  
(Ahtisaari) Autonomi për Serbët?

Prishtinë, shkurt 2013



# **Zgjidhje**

## **A garanton Kushtetuta e Kosovës (Ahtisaari) autonomi për serbët?**

Kjo analizë u realizua për Forum 2015  
Nga Shkëlzen Gashi

Shkurt 2013



Authors:  
Shkëlzen Gashi

2013 Kosovo Foundation for Open Society

The views expressed in this publication do not necessarily reflect the views of the Kosovo Foundation for Open Society (KFOS).

Published by:  
Forum 2015 - KFOS operational project  
Imzot Nikë Prela nr. 13  
10 000 Pristina  
Kosovo

For more information contact:  
[info@kfos.org](mailto:info@kfos.org)  
[www.kfos.org](http://www.kfos.org)

# PËRMBAJTJA

|  |    |
|--|----|
| 1. Hyrja   | 5  |
| 2. Llojet e autonomive   | 7  |
| 3. Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (2007) | 9  |
| 4. Autonomitë në regjion   | 17 |
| 4.1. Marrëveshja Kornizë 2001  | 17 |
| 4.2. Statuti i Krahinës Autonome të Vojvodinës 2008                      | 21 |
| 5. Autonomitë në Europë  | 25 |
| 5.1. Statusi i Autonomisë i Tirolit të Jugut 1972                        | 25 |
| 5.2. Statuti i Autonomisë i Katalonisë 2006                              | 28 |
| 6. Përfundime  | 6  |



## 1. HYRJA

Në negociatat Kosovë-Sërbi, të ndërmjetësuara nga BE-ja, veç tjerash, po diskutohet edhe për statusin e serbëve në Kosovë. Meqenëse përfaqësues të ndryshëm ndërkombëtarë, përfshi organizime si Grupi Ndërkombëtar i Krizave dhe Fondacioni Carnegie për Europë, janë deklaruar se zgjidhja e statusit të serbëve në Kosovë, sidomos në veri, duhet të jetë një lloj autonomie e bazuar në modelet e autonomive në Europë, del e nevojshme të zërthehen shkurtimisht llojet më përfaqësuese të këtyre autonomive, e që janë përmendë më së shumti, si: Tiroli i Jugut (Itali) dhe Katalonia (Spanjë).

Përveç kësaj, ky raport synon të zërthejë edhe disa prej autonomive në pjesë të ndryshme të territorit të ish-Jugosllavisë. Përveç autonomisë së serbëve në Kosovë në bazë të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të përgatitur nga Emisari Special i Sekretarit Gjeneral të OKB-së për zgjidhjen e statusit të Kosovës (2007), ky raport mëton t'i zërthejë edhe: autonominë e komunitetit shqiptar në Maqedoni në bazë të Marrëveshjes Kornizë (2001); dhe autonominë e Vojvodinës në Sërbi në bazë Statutit të Vojvodinës (2008).

Qëllimi i këtij raporti është që të mos shkaktohet huti më pas se çfarë është statusi i serbëve të Kosovës, ose më saktësisht i veriut të Kosovës, në bazë të dokumentit që do të dalë si rezultat i negociatave Kosovë-Sërbi. Prandaj, ky publikim mund t'u hy në punë jo vetëm atyre që janë të involvuar në mënyrë të dretpërdrejtë në këto negociata me Sërbinë, por edhe atyre që do të jenë të involvuar në mënyrë më të tërthortë, si: politikanët opozitarë, gazetarët, publicistët, aktivistët e shoqërisë civile, profesorët, e me radhë. Për më shumë, ky raport synon me shërby edhe si nxitës i një debati në shoqërinë kosovare në lidhje me statusin që duhet të kenë serbët e Kosovës.



## 2. LLOJET E AUTONOMIVE

Hierarkia e të drejta të minoriteteve nisë me parimin e **jodiskriminimit** dhe të **drejtave të barabarta**, vazhdon me të **drejtat speciale**, të cilat mund të jenë të **drejta individuale** dhe të **drejta kolektive**. Nëse të **drejtat kolektive** arrijnë një nivel të caktuar të **vetëvendosjes** (është fjala për vetëvendosje **interne**, e jo për vetëvendosje **eksterne**), atëherë fitojnë statusin e **autonomisë**, e cila paraqet maksimumin e statusit legal që një minoritet mund të arrijë brenda një shteti.

Sikurse edhe për shumë koncepte tjera politike, as për autonominë nuk ka një definicion të pranuar universalisht. Megjithëkëtë, ka një konsensus se, në thelb, autonomitë, si shkalla më e lartë e vetëqeverisjes, ndahen në dy lloje: **autonomi territoriale** të cilat bazohen në territor; dhe **autonomi joterritoriale** të cilat nuk bazohen në territor, por në pjesëtarët e grupit minoritar, e që ndryshe njihen edhe si **autonomi personale ose kulturore**. Autonomitë **joterritoriale** nuk kanë të bëjnë me territorin, por me të gjithë anëtarët e minoritetit, të cilët kanë të drejtë për vetëqeverisje përmes **organizatave, asociacioneve ose institucioneve** në: **kulturë, arsim, gjuhë dhe fe**. Anëtarësia në këto asociacione është e kufizuar veç për anëtarët e grupit minoritar, pavarësisht se në cilën pjesë të territorit të shtetit jetojnë. Këto organizime kanë të drejtë të krijojnë një strukturë ombrellë për koordinim të brendshëm të çështjeve të minoritetit dhe për prezentim të jashtëm në mënyrë që minoriteti të flas me një zë. Ky lloj i autonomisë zakonisht aplikohet në rastet kur grupi minoritar është i shpërndarë gjeografikisht.<sup>1</sup>

Në anën tjetër, autonomitë **territoriale** përgjithësisht nënkuptojnë vetëqeverisjen e një njësie të veçantë territoriale në kuadër të shtetit. Kjo njësi duhet të ketë karakteristika **etnike, kulturore, gjuhësore e fetare** të grupit dominant në kuadër të vet, ku pushteti ushtrohet drejtpërdrejt nga njësi autonome. Përgjithësisht, autonomitë **territoriale** duhet të kenë institucione **legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore**, që do të thotë, me pasë në nivel lokal-regional: **asamble, qeveri dhe gjykata**. Autonomitë mund të futen në legjislacion, në kushtetutë, e në disa raste bëhen me marrëveshje ndërkombëtare, por nuk nënkuptojnë **vetëvendosje eksterne**. Njësi autonome edhe qeveria qendrore mund të ushtrojnë drejtpërdrejt pushtet publik sa i takon individëve në kuadër të territorit autonom, në çështjet ku kompetencat e

1 Brunner, Georg and Herbert Kupper. *European Options of Autonomy: A Typology of Autonomy Models of Minority Self-Governance*. Në: Kinga Gal (ed). *Minority Governance in Europe*. Budapest: Series on Ethnopolitics and Minority Issues, 2002.



njësisë autonome dhe qeverisë janë të ndara. Autonomitë ose nuk duhet të kenë fare pushtet në punët e jashtme ose pushtet të kufizuar për “marrëveshje ekzekutive” në fushën e tregtisë ose kuturës, e në disa raste mundësi për zhvillim të lidhjeve speciale me shtetet fqinje ose me regjione nga shtetet fqinje. Pushteti i autonomisë duhet të balansohet për të siguruar integrimin e saj në kuadër të shtetit, duke përfshi definimin e mekanizmave për zgjidhjen e problemeve mes shtetit dhe autonomisë, bartjen e resurseve dhe përfaqësimin e autonomisë në shtet.<sup>2</sup>

---

2 Weller, Marc and Catherine Nobbs (ed). *Asymmetric Autonomy and the Settlement of Ethnic Conflicts*. Philadelphia: University of Pennsylvania Press, 2010. Për të pa shtjellime të modeleve të ndryshme të autonomive në botë, për këtë publikim është marrë në konsideratë edhe një prej studimeve më të shquara në këtë fushë: Hannum, Hurst. *Autonomy, Sovereignty, and Self-Determination – the accommodation of conflicting rights*. Philadelphia: University of Pennsylvania Press, 1990.

### 3. PROPOZIMI GJITHËPËRFSHIRËS PËR ZGJIDHJEN E STATUSIT TË KOSOVËS (2007)

Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës, dispozitat e të cilit kanë përparësi mbi të gjitha dispozitat e tjera legale në Kosovë, përcakton që Kosova të jetë **shoqëri shumetnike**, që respekton, në nivelin më të lartë të njohur ndërkombëtarisht, **të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale** dhe që promovon e mbron **të drejtat e komuniteteve dhe të anëtarëve të tyre**, me theks të veçantë te komunitetet e cenushme.<sup>3</sup> Sipas këtij propozimi, Kosova duhet të garantojë dhe të mbrojë **identitetin kombëtar ose etnik, kulturor, gjuhësor e religjioz të komuniteteve**.<sup>4</sup> Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë që të gëzojnë kontakte të papenguara mes vete përbrenda Kosovës dhe të themelojnë e të mbajnë kontakte të lira dhe paqësore me personat në cilindo shtet, në veçanti me ata me të cilët ndajnë **identitetin kombëtar ose etnik, kulturor, gjuhësor e fetar dhe trashëgiminë e përbashkët kulturore**, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare.<sup>5</sup>

Pjesëtarët e komuniteteve, në bazë të këtij propozimi, kanë të drejtë që të kenë kontakte të papenguara dhe të marrin pjesë, pa diskriminim, në aktivitetet e organizatave joqeveritare lokale, regjionale e ndërkombëtare dhe **të themelojnë shoqata për kulturë, art, shkencë dhe arsim si dhe shoqata të studiuesve dhe shoqata të tjera për shprehjen, avancimin dhe zhvillimin e identitetit të tyre**.<sup>6</sup> Këto iniciativa të komuniteteve, Qeveria e Kosovës e ka për obligim me i përkrahë, madje edhe financiarisht. Po ashtu, institucionet e Kosovës duhen me marrë masa për t'i mbrojtë ata që mund t'u nënshtrohen kërcënimeve, diskriminimit, armiqësisë apo dhunës, shkaku i identitetit kombëtar ose etnik, kulturor, gjuhësor e fetar, por edhe veprime kundër atyre që pengojnë gëzimin e të drejtave të pjesëtarëve të komuniteteve dhe që synojnë asimilimin e tyre. Gjithashtu, institucionet e Kosovës duhet të promovojnë barazi mes pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike e kulturore.<sup>7</sup>

3 Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës, neni 1, Dispozitat e Përgjithshme, paragrafi 1.1 dhe 1.2. Shih edhe: Aneksi I, Dispozitat Kushtetuese, neni 1 Dispozitat Themelore, Kushtetuta e Kosovës, 1.1.

4 Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës, neni 3, Të drejtat e Komuniteteve dhe Anëtarëve të Tyre.

5 Aneksi 2, neni 3, Të drejtat e komuniteteve dhe Anëtarëve të Tyre, pika l.

6 Aneksi 2, neni 3, Të drejtat e komuniteteve dhe Anëtarëve të Tyre, pikat m dhe n.

7 Aneksi 2, Të drejtat e komuniteteve dhe Anëtarëve të Tyre, neni 2 Detyrimet për Kosovën, pika 2.1, 2.3, 2.4 dhe 2.6.

Duhet thënë edhe se komunitetet minoritare të Kosovës, **posaçërisht sërëbët**, sipas propozimit, vazhdojnë të ballafaqohen me kushte të vështira të jetesës, dhe se dhuna e ushtruar kundër tyre në verë të vitit 1999 e në mars të vitit 2004 ka lënë pasojë të thella,<sup>8</sup> prandaj ky propozim kufizohet posaçërisht në nevojat specifike dhe shqetësimet e **komunitetit sërëb në Kosovë**, i cili, po sipas këtij propozimi, duhet të ketë shkallë të lartë të kontrollit për çështjet e veta.

Kështu, në bazë të këtij propozimi, njësitë themelore të vetëqeverisjes – **komunat** – gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe kanë kompetenca të plota e ekskluzive, për aq sa ato kanë të bëjnë me interesin lokal. Disa komuna të caktuara **me shumicë sërëbe kanë kompetenca të zgjeruara**, si p.sh. në: **arsim të lartë, ofrim të kujdesit shëndetësor sekondar dhe mbrojtje e promovim të trashëgimisë fetare dhe kulturore të sërëbëve**. Përveç krijimit të pesë komunave të reja me shumica sërëbe, ky propozim thotë që Kosova të hyjë në konsultime me **komunitetet joshumicë**, që, në rastet kur këto komunitete përbëjnë së paku 75% të popullsisë në një vendbanim të përqendruar me popullsi të gjithëmbarshme prej së paku 5000 banorësh, të mund të krijojnë komunë të re.<sup>9</sup>

Sa u takon burimeve **financiare**, komunat kanë të drejtë të mbledhin tatime lokale, pagesa dhe tarifa, por jo të mbledhin tarifa doganore, tatime në të ardhura, tatime mbi vlerën e shtuar, detyrime të akcizës, tatime në kapital, përveç tatimeve në pronën e paluajtshme që gjendet në territorin e komunës. Shpërndarja e granteve të përgjithshme duhet me marrë parasysh, *inter alia*, madhësinë fizike të komunës, numrin e banorëve, duke përfshi **numrin e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë** në komunë, dhe qasjen përkatëse të banorëve të komunës në shërbimet publike. Komunat **me kompetenca të zgjeruara kanë të drejtë në fonde qendrore shtesë**. Komunat mund të kontestojnë pranë Gjykatës Kushtetuese, kushtetutshmërinë e ligjeve ose akteve të Qeverisë që cenojnë përgjegjësitë e tyre ose që zvogëlojnë të hyrat e tyre.<sup>10</sup>

Përveç burimeve **lokale** të të ardhurave dhe atyre **qendrore**,<sup>11</sup> komunat me shumicë sërëbe kanë të drejtë të bashkëpunojnë me komunat dhe institucionet e sërëbisë për **ndihmë financiare** dhe teknike, duke përfshi ndihmën me ekspertë dhe pajisje, për ushtrimin e përgjegjësisë të komunës në fushat e kompetencave të saj. Komunat mund ta pranojnë ndihmën financiare nga sërëbia nëpërmjet kontove bankare në bankat e çertifikuara nga autoriteti qendror bankar i Kosovës dhe duhet t'i raportojnë këto ndihma së bashku me shpenzimet gjegjëse në buxhetet e tyre komunale. Ndihamat

8 Shih Raportin e Emisariatit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Statusin e Ardhshëm të Kosovës.

9 Aneksi 3, Decentralizimi, neni 3, Kompetencat Komunale, pika 3.1 dhe neni 4 Kompetencat e Zgjeruara Vetjake Komunale, pika 4.1: 4.1.1, 4.1.2 dhe 4.1.3. a. Po ashtu, shih edhe neni 12 Krijimi i Komunave të Reja, saktësisht pika 12.4.

10 Aneksi 3, Decentralizimi, neni 8, Financat Lokale, saktësisht 8.2, 8.3.2 dhe 8.4. Shih edhe Ankesin 1 Dispozitat Kushtetuese, neni 6 Gjykata Kushtetuese dhe Sistemi i Drejtësisë, pika 6.3.

11 Aneksi I Dispozitat Kushtetuese, neni 8 Decentralizimi/Vetëqeverisja Lokale, 8.3.

financiare nga sërbia nuk kompensojnë dhe zvogëlojnë ndarjen e granteve dhe burimeve të tjera që u ofrohen komunave dhe nuk u nënshtrohen kurrfarë tatimeve nga ndonjë autoritet qendror i Kosovës. Për një bashkëpunim të tillë, komunat paraprakisht duhet ta njoftojnë Ministrinë e Pushtetit Lokal të Kosovës, e cila ka të drejtë që, nëse ky bashkëpunim nuk është në pajtueshmëri me legjislacionin qendror, të urdhërojë ndryshime ose edhe ta pezullojë këtë bashkëpunim. Komuna, nga ana e saj, mund ta kundërshtojë këtë në gjykatën e qarkut që është kompetente për territorin e komunës. Duhet thënë edhe se për ta nxitë bashkëpunimin me institucionet në Republikën e sërbisë parashihet **themelimi i një komisioni të përbashkët sërbi-Kosovë**.<sup>12</sup>

Komunat me shumicë sërbe kanë të drejtë të bashkëpunojnë e të krijojnë **partneritete** mes vete për zbatimin e **përgjegjësiave komunale dhe kompetencave të zgjeruara**, *inter alia*, përmes: themelimit të një **organi vendimmarrës** me përfaqësues të komunave pjesëmarrëse dhe vendimeve për financim dhe nevoja tjera operationale të partneritetit. Këto partneritete kanë të drejtë për **marrëdhënie të drejtpërdrejta me institucionet në sërbi** vetëm deri në masën e nevojshme për zbatimin e aktiviteteve të partneritetit. Vendimet dhe aktivitetet e partneritetit duhet t'u nënshtrohen kërkesave për raportim te autoriteti kompetent qendror, si dhe shqyrtimit administrativ për pajtueshmëri me legjislacionin. Komunat e angazhuara në partneritet duhet të **publikojnë informatat për aktivitetet dhe buxhetin e partneritetit**.<sup>13</sup>

Në lidhje me gjuhët, sipas këtij propozimi, **zyrtare** në Kosovë janë **gjuha shqipe dhe gjuha sërbe**, kurse gjuha turke, boshnjake dhe rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komunal ose janë në përdorim zyrtar në përputhje me ligjin. Kosova garanton mbrojtjen dhe zhvillimin e **identitetit gjuhësor** të të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre dhe respekton standardet e parashikuara me Kartën Evropiane për Gjuhët Regjionale ose të Pakicave.<sup>14</sup> Po ashtu, pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë, në mënyrë individuale ose si komunitet, që të kenë qasje të garantuar dhe **përfaqësim të posaçëm në mediat transmetuese publike** si dhe t'i kenë programet në **gjuhën** e tyre, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare. Ata kanë **të drejtë për t'i krijuar dhe përdorë mediat e tyre**. Kosova ka për t'i mundësuar komunitetit sërb në Kosovë qasje në **një kanal televiziv të pavarur, të licencuar në gjuhën sërbe në mbarë Kosovën**.<sup>15</sup>

12 Aneksi 3, Decentralizimi, neni 10 Bashkëpunimi me Institucionet në Republikën e sërbisë dhe neni 11 Financimi i aktiviteteve komunale nga Republika e sërbisë.

13 Aneksi 3, Decentralizimi, neni 9 Bashkëpunimi Ndërkomunal, pika 9.1.1, 9.1.2 dhe 9.1.3.

14 Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës, neni 1, Dispozitat e Përgjithshme, pika 1.6 dhe Aneksi II Të Drejtat e Komuniteteve dhe Anëtarëve të Tyre, neni 2, Neni 2 Detyrimet për Kosovën, pika 2.2.

15 Aneksi II Të Drejtat e Komuniteteve dhe Anëtarëve të Tyre, neni 3, pika 3.1. j dhe k.

Me këtë propozim, pjesëtarët e komunitetit serb kanë të drejtë që të pranojnë **arsimim publik në të gjitha nivelet**, por edhe të themelojnë dhe menaxhojnë institucionet private të arsimit për të cilat mund të jepet ndihma financiare publike, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare. Shkollat që ofrojnë mësim në gjuhën serbe mund të **zbatojnë planprograme ose tekste shkollore të serbisë**, me njoftim të Ministrisë së Arsimit të Kosovës. Në rast se Ministria e Arsimit e Kosovës kundërshton, çështja i referohet një komisioni të pavarur (3 shqiptarë, 3 serbë dhe një ndërkombëtar) për të shqyrtuar pajtueshmërinë e planprogramit ose të tekstit shkollor me kushtetutën dhe ligjet e miratuara në pajtim me këtë marrëveshje. Sa i përket arsimit të lartë në gjuhën serbe, parashihet **themelimi i Universitetit të Mitrovicës Veriore**, i cili në statutin e vet do t'i saktësojë procedurat dhe ndërveprimin me autoritetet publike, në pajtim me legjislationin qendror, i cili do të shqyrtohet nga një komision i pavarur. Komuna e Mitrovicës Veriore do të ketë autoritet për të siguruar që ky universitet të ketë objekte dhe financim adekuat për veprimtarinë e vet.<sup>16</sup>

Për të siguruar **përfaqësim** adekuat të komuniteteve minoritare në jetën publike, ky propozim përcakton **mekanizma për përfaqësim special** në institucionet kryesore. Për shembull, për dy mandatet e para zgjedhore pas miratimit të Kushtetutës së Kosovës, në Kuvendin e Kosovës, prej 120 ulëseve, **20 janë të rezervuara për përfaqësim të komuniteteve joshumicë në Kosovë: 10 për komunitetin serb dhe 10 për komunitetet tjera, kurse çdo ulëse e fituar përmes zgjedhjeve do të jetë ulëse shtesë**. Pas dy mandateve të para zgjedhore, përfaqësuesit e komunitetit serb të Kosovës do të kenë numrin e ulëseve në Kuvend të fituar përmes zgjedhjeve, me **minimum 10 ulëse të garantuara në rast se numri i ulëseve të fituara është më i vogël se 10**. Deputetët e komunitetit serb do të kenë: së paku një përfaqësues në Kryesinë e Kuvendit; së paku një zëvendëskryesues në secilin komision parlamentar do të jetë nga komuniteti tjetër prej atij që i përket kryesuesi; së paku një ministër dhe dy zëvendësministra do të jenë nga komuniteti serb. Në komunat në të cilat së paku 10% e banorëve i përkasin komuniteteve joshumicë, posti i zëvendëskryetarit për komunitete rezervohet për një përfaqësues të komuniteteve, kurse posti tjetër i zëvendëskryetarit do të mbahet nga kandidati që i përket popullatës joshumicë që ka marrë shumicën e votave.<sup>17</sup>

16 Aneksi 3, Decentralizmi, neni 7 Arsimi, pika 7.1 dhe 7.2.

17 Aneksi I Dispozitat Kushtetuese, neni 3 Kuvendi i Kosovës e neni 5 Qeveria e Kosovës dhe Aneksi II Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre, neni 4 Pjesëmarrja e Komuniteteve dhe Anëtarëve të Tyre në Jetën Publike dhe në Vendimmarrje.

Karakterit shumetnik i Kosovës duhet të pasqyrohet edhe në përbërjen e **shërbimit civil** dhe këtë e garanton edhe ky propozim. Po ashtu, ky propozim garanton që përbërja, sa i përket rekrutimit, përzgjedhjes, emërimit, avancimit në detyrë dhe transferit të **gjyqtarëve dhe prokurorëve**, ta pasqyrojë karakterin shumetnik të Kosovës dhe një përfaqësim të barabartë proporcional të të gjitha komuniteteve në Kosovë, duke u dhënë përparësi pjesëtarëve të komuniteteve që nuk janë përfaqësuar sa duhet.<sup>18</sup>

Përbërja dhe shërbimi i gjyqësisë dhe prokurorisë do ta pasqyrojë shumëllojshmërinë e etnike të Kosovës dhe nevojën për përfaqësimin e barabartë të të gjitha komuniteteve. Së paku 15% të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, por në asnjë rast më pak se 3 gjyqtarë, do të vijnë nga komunitetet jo shumicë të Kosovës. Së paku 15% të gjyqtarëve të secilës gjykatë të qarkut, por në asnjë rast më pak se 2 gjyqtarë, do të vijnë nga komunitetet jo shumicë të Kosovës. Komuna ku shumica e popullatës i takon komunitetit jo shumicë të Kosovës, mund ta parqet kërkesën para Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për themelimin e gjykatës themelore në territorin e saj, ose që një nga gjykatat ekzistuese themelore në territorin e komunës tjetër të ketë juridiksion mbi komunën e re. Nëse KGJK nuk e aprovon kërkesën për themelimin e gjykatës së re themelore pasi mund të vlerësojë se norma e lëndëve është e pamjaftueshme për ta arsyetuar ekzistimin e gjykatës së veçantë, ose kur komuna i kërkon gjykatës ekzistuese që ta shtrijë kompetencën e saj edhe në territorin e vet, themelohen zyre ndërlidhëse ose gjykata themelore mbanë seancat në territorin e komunës së re.<sup>19</sup>

Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të ndërmerr masa të nevojshme për shtimit të numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga radhët e komuniteteve të Kosovës të cilat aktualisht janë të nën-përfaqësuar në mesin e gjyqtarëve dhe prokurorëve që shërbejnë në Kosovë dhe në çdo pjesë tjetër përkatëse. Për përmbushjen e përgjegjësisë të veta në këtë drejtim, KGJK, në mes tjerash, në mesin e kandidatëve me kualifikime të barabarta për funksionin e gjyqtarit dhe prokurorit, do t'i jep përparësi pjesëtarëve të komuniteteve të nën-përfaqësuar. Dhënia e përparësisë për kandidatët me kualifikime të barabarta nga komunitetet e nën-përfaqësuar, do të zbatohet deri atëherë kur përqindja e gjyqtarëve dhe prokurorëve pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë në Kosovë të jetë nën 15% dhe/ose deri atëherë kur përqindja e gjyqtarëve

18 Aneksi I, Dispozitat Kushtetuese, neni 5 Qeveria e Kosovës, pika 5.4 dhe neni 6 Gjykata Kushtetuese dhe Sistemi i Drejtësisë, pika 6.6.

19 Aneksi IV Sistemi i Drejtësisë, neni 1 dhe 2.

dhe prokurorëve të cilët janë pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës, të jetë nën 8%. KGJK do të përbëhet nga 13 anëtarë, ku dy prej tyre do t'i zgjedhin deputetët e Kuvendit të Kosovës të cilët mbajnë ulëset e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komunitetit serb të Kosovës, 2 anëtarë do të zgjedhën nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë ulëset e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve tjera, dhe 2 anëtarë do të zgjedhën nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë ulëset e fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të ulëseve.<sup>20</sup>

Propozimi siguron që komunitetet dhe pjesëtarët e tyre të kenë të drejtë për përfaqësim të barabartë proporcional në **punësim në organet publike dhe ndërmarrjet publike në të gjitha nivelet**, përfshi këtu në veçanti sektorin e **policisë** në zonat e banuara me komunitetin përkatës, duke respektuar në të njëjtën kohë rregullat që kanë të bëjnë me kompetencën dhe integritetin që qeveris administratën publike.<sup>21</sup> Komunitat në të cilat komuniteti serb është shumicë do të kenë të drejta të avancuara pjesëmarrëse në zgjedhjen e komandantëve të stacioneve **policore** (kufijtë e stacioneve policore rajonale janë të njëjtë me kufijtë komunalë), duke propozuar së paku dy emra për komandantë stacioni, njërin prej të cilëve duhet ta emërojë Ministria e Punëve të Brendshme. Duhet cekë se në nivel të Kosovës ruhet zinxhiri i unifikuar i komandës së policisë.<sup>22</sup> Po ashtu, Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) duhet të reflektojë karakterin shumetnik të Kosovës.<sup>23</sup>

Ky propozim përcakton **procedura speciale parlamentare**: pa votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm të Kuvendit të Kosovës që u përkasin komuniteteve joshumicë në Kosovë, nuk mund të miratohen, ndryshohen a shfuqizohen: ligjet që ndryshojnë kufijtë komunalë, themelojnë ose shuajnë komunat, përcaktojnë shtrirjen e pushteteve të komunave dhe pjesëmarrjen e tyre në marrëdhëniet ndërkomunale e tejkufitare; ligjet që implementojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, përveç atyre të përcaktuara me kushtetutë; ligjet për përdorimin e gjuhëve; për zgjedhjet lokale; për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore; për lirinë fetare ose për marrëveshjet me komunitetet fetare; për arsimin; për përdorimin e simboleve (përfshirë simbolet e komunitetit) dhe festat publike. Dhjetë a më shumë deputetë të Kuvendit, mes tjerash, do të kenë të drejtën që të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji a vendimi të miratuar nga Kuvendi pranë Gjykatës Kushtetuese, si në aspektin përmbajtësor, ashtu edhe në atë procedural. Për çdo ndryshim të Kushtetutës do të kërkohet miratimi i dy të tretave të deputetëve të Kuvendit, përfshirë këtu dy të

20 Aneksi IV Sistemi i Drejtësisë, neni 4.

21 Aneksi II Të Drejtat e Komuniteteve dhe Anëtarëve të Tyre, neni 4 Pjesëmarrja e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Jetën Publike dhe në Vendimmarrje, pika 4.4.

22 Aneksi VIII, Sektori i Sigurisë së Kosovës, neni 2 Policia.

23 Aneksi VIII, Sektori i Sigurisë së Kosovës, Neni 5 Forca e Sigurisë së Kosovës, pika 5.5.

treatat e deputetëve të Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.<sup>24</sup>

Në sferën e **religjionit**, Kosova ka detyrë të posaçme për të siguruar mbrojtje efektive të tërësive të objekteve dhe monumenteve të rëndësisë kulturore dhe fetare për komunitetet. Prania Ushtarake Ndërkombëtare duhet të garantojë siguri fizike shtesë për këto monumente deri kur të vendoset se janë pjekë kushtet për t'ia bartë këto përgjegjësi Policisë së Kosovës. Kosova e njeh Kishën Ortodokse serbe (KOS) në Kosovë si pjesë integrale e KOS-it me seli në Beograd dhe i ofron siguri shtesë dhe masa të tjera mbrojtëse për gëzimin e plotë të të drejtave, privilegjeve dhe imuniteteve të tyre, por KOS në Kosovë ka detyrë dhe përgjegjësi me vepru në pajtim me ligjet e Kosovës. KOS në Kosovë është pronarja e vetme e pronës së saj në Kosovë, me liri të plotë për menaxhimin dhe rindërtimin e saj. Për më shumë, kjo pronë është e paprekshme dhe nuk i nënshtrohet shpronësimit. Autoritetet e Kosovës kanë qasje në këtë pronë vetëm me pëlqimin nga Kisha ose në rastet kur lëshohet urdhër gjyqësor në lidhje me aktivitetet joligjore, ose në rast të rrezikut të drejtpërdrejtë për jetën dhe shëndetin. KOS në Kosovë mund të pranojë donacione dhe të përfitojë nga përkrahja tjetër nga çdo institucion brenda ose jashtë Kosovës, por në mënyrë plotësisht transparente. Kosova i ofron KOS-it në Kosovë **privilegje doganore dhe tatimore**, krahas atyre privilegjeve që i gëzojnë të gjitha fetë në Kosovë, për aktivitetet ekonomike që janë specifike për vetëqëndrueshmëri financiare të Kishës.<sup>25</sup>

Një numër i zgjedhur i manastireve, kishave dhe objekteve tjera fetare të KOS-it në Kosovë, si dhe objektet historike dhe kulturore të rëndësisë së veçantë për serbët në Kosovë, gëzojnë **mbrojtje të veçantë**, ku ndalohet – pa paragjykuar pronësinë e pasurisë në kuadër të **zonës mbrojtëse** – ndërtimi ose zhvillimi industrial si: zbulimi e eksplorimi i resurseve minerale; ndërtimi i pendave, centraleve për prodhimin e energjisë ose rrjetit të energjisë, furrave e fabrikave, rrugëve transit për në viset rurale, si dhe ndërtimi ose zhvillimi që shpie në shpyllëzimin ose ndotjen e ambientit. Po ashtu, komuna përkatëse duhet të kërkojë pëlqimin e KOS-it në Kosovë para kryerjes së këtyre aktiviteteve në kuadër të **zonës mbrojtëse**: ndërtime komerciale; tubime publike, rekreative dhe zbavitëse; urbanizim të tokës bujqësore. Për ta mbikëqyrë dhe lehtësu implementimin e këtyre të drejtave speciale për KOS-in në Kosovë dhe objektet kulturore dhe religjioze serbe në Kosovë parashihet të themelohet Këshilli

<sup>24</sup> Aneksi I Dispozitat Kushtetuese, neni 3 Kuvendi i Kosovës, pika 3.7, neni 6 Gjykata Kushtetuese dhe Sistemi i Drejtësisë, pika 6.2 dhe neni 10 Ndryshimet Kushtetuese, pika 10.1.

<sup>25</sup> Aneksi 5, Trashëgimia Fetare dhe Kulturore, neni 1 Emri, Organizimi i Brendshëm dhe Prona e Kishës Ortodokse serbe dhe neni 2 Përkrahja Ekonomike dhe Përkrahja Tjetër.



për Zbatim dhe Mbikëqyrje.<sup>26</sup>

Përveç zgjidhjes së fatit të personave të pagjetur, ky propozim parasheh edhe kthimin e refugjatëve dhe personave të zhvendosur, por duke ripohuar parimin se **personat e zhvendosur mund të kthehen në vendin që e zgjedhin ata në Kosovë**, e jo vetëm në vendin origjinal të tyre të banimit.<sup>27</sup> Po ashtu, ky propozim urdhëron procedura transparente për t'i zgjidhë **pretendimet e diskutueshme pronësore**, por edhe për **procesin e privatizimit**, me ndërhyrje përmbajtësore ndërkombëtare.<sup>28</sup> Për fund, bashkësia ndërkombëtare, konkretisht prania civile ndërkombëtare dhe prania ushtarake ndërkombëtare, duhet të supervizojnë, monitorojnë dhe të kenë pushtetin e nevojshëm për të garantuar zbatimin në tërësi të kësaj marrëveshjeje.<sup>29</sup>

---

26 Aneksi 5, Trashëgimia Fetare dhe Kulturore, neni 3 Siguria për Objektet Fetare dhe Kulturore, neni 4 Zonat e Mbrojtura dhe neni 5 Këshilli Zbatues dhe Mbikëqyrës.

27 Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës, neni 4 Të drejtat e Refugjatëve dhe të Personave të Zhvendosur dhe neni 5 Personat e Zhdukur.

28 Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës, neni 8 Çështjet Ekonomike dhe Pronësore.

29 Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës, neni 12 Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar dhe neni 14 Prania Ushtarake Ndërkombëtare.

## 4. AUTONOMITË NË REGJION

### 4.1. Marrëveshja Kornizë 2001

Marrëveshja Kornizë e vitit 2001 për ndërprerjen e armiqësive, çarmatosjen dhe shpërbërjen e grupeve të armatosura të **shqiptarëve etnikë** në Maqedoni, synon të promovojë zhvillimin e shoqërisë civile, duke respektuar **identitetin etnik** dhe interesat e të gjithë qytetarëve të Maqedonisë. Në këtë marrëveshje precizohet se **sovrانيتi, integriteti territorial dhe karakteri unitar** i Maqedonisë janë të paprekshëm e se duhet të ruhen, kurse **karakteri shumetnik** i shoqërisë së Maqedonisë duhet të reflektohet në jetën publike. Kjo marrëveshje qartëson se për **problemet etnike nuk mund të ketë zgjidhje territoriale** dhe se Maqedonia duhet të garantojë që kushtetuta e saj t'i plotësojë nevojat e të gjithë qytetarëve sipas **standardeve më të larta ndërkombëtare**.<sup>30</sup>

Me qëllim të promovimit të respektit për **identitetin e komuniteteve**, marrëveshja aspiroon zhvillimin e **vetëqeverisjes lokale**. Në këtë kuadër, ajo parasheh forcimin dhe zgjerimin përmbajtësor të kompetencave të **njësive lokale të vetëqeverisjes**, në përputhje me **Kartën Europiane për Vetëqeverisje Lokale**, në këto fusha: shërbime publike, planifikim urban e rural, mbrojtje e ambientit, zhvillim lokal ekonomik, kulturë, sport, financa lokale, edukim, mirëqenie sociale dhe shërbim shëndetësor.<sup>31</sup> **Njësitë lokale të vetëqeverisjes** parashihet të kenë resurse për t'i kry detyrat sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, përfshi këtu të drejtën për me mbledhë taksë dhe, në bazë të funksioneve që kanë këto njësi, me marrë një pjesë të taksave që mbledhen në këto njësi nga niveli qendror.<sup>32</sup>

Komunitetet kanë të drejtë të shprehin e të zhvillojnë identitetin e tyre gjuhësor, kulturor, religjioz dhe të themelojnë institucione për arsim, shkencë e kulturë.

Sa i takon **gjuhës**, në bazë të marrëveshjes, gjuhë zyrtare në territorin e Maqedonisë dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare të saj është gjuha maqedone. Çdo gjuhë tjetër që flitet të paktën nga **20%** e popullatës është po ashtu gjuhë zyrtare, por kjo ka të bëjë me **njësitë lokale vetëqeverisëse**, ku nëse një komunitet përbën të paktën **20%** të popullatës së asaj njësie, gjuha e tij përdoret po ashtu si gjuhë zyrtare. Pjesëtarët që i takojnë komunitetit që përbën të paktën **20%** të popullatës në njësinë lokale

30 Marrëveshja Kornizë, neni I Parimet Themelore, pikat 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4.

31 Marrëveshja Kornizë, neni I Parimet Themelore, pika 1.5 dhe neni 3 Zhvillimi i Qeverisjes së Decentralizuar, pika 3.1.

32 Ankesi B Ndryshimet Legjislative, neni 2 Ligji për Financa Lokale.

vetëqeverisëse, mund ta përdorin gjuhën e tyre për të komunikuar me zyrat regjionale të qeverisë qendrore me përgjegjësi për atë komunë, por edhe me zyrën kryesore të qeverisë qendrore. Po ashtu, në seancat gjyqësore penale dhe civile në çdo nivel, personi i akuzuar ka të drejtën për përkthim me shpenzime të shtetit për të gjitha seancat dhe dokumentet. Sa u përket dokumenteve zyrtare personale, qytetarëve që e flasin një gjuhë zyrtare tjetër prej asaj maqedone, duhet që t'u lëshohen dokumentet edhe në gjuhën e tyre.<sup>33</sup>

Sipas marrëveshjes, **edukimi** fillor e ai i mesëm duhet të zhvillohen në gjuhën amtare të nxënësve, kurse për programet akademike duhet të përdoren **standarde uniforme** në tërë territorin e Maqedonisë. Sa për nivelin universitar, në bazë të marrëveshjeve specifike, shteti duhet të sigurojë financim për edukimin në gjuhën që flitet nga të paktën **20%** e popullatës së Maqedonisë. Po ashtu, marrëveshja garanton se do të aplikohet parimi i **diskriminimit pozitiv** sa i takon regjistrimit në universitete shtetërore të kandidatëve që u përkasin **komuniteteve joshumicë** në popullatën e Maqedonisë, derisa regjistrimi të reflektojë në mënyrë të barabartë përbërjen e popullatës së Maqedonisë. Gjuha maqedone duhet të mësohet në shkollat ku edukimi bëhet në gjuhë të tjera.<sup>34</sup>

Në lidhje me **religjionin**, marrëveshja garanton lirinë dhe të drejtën për me e shprehë besimin lirisht e publikisht, dhe individualisht ose me të tjerët. Komunitetet religjioze, Kisha Ortodokse Maqedone, Komuniteti Religjioz Islamik dhe Kisha Katolike, sipas kësaj marrëveshjeje, janë të ndara prej shtetit, të barabarta para ligjit dhe të lira për të themelua shkolla dhe institucione të tjera shoqërore e bamirëse, të rregulluara me ligj.<sup>35</sup> Sa i përket përfaqësimit/punësimit të **komuniteteve joshumicë** ose të **nënpërfaqësuar** në administratë, në ushtri dhe në ndërmarrje publike, por edhe qasjes së këtyre në financa publike për zhvillimin e biznesit, marrëveshja merr parasysh parimin e **mosdiskriminimit** dhe të **përfaqësimit të barabartë**. Në Këshillin e Sigurisë të Maqedonisë, Presidenti i Republikës ka të drejtë që të caktojë tre anëtarë për të siguruar se aty reflektohet përbërja e popullatës së Maqedonisë. Po ashtu, kjo marrëveshje paralajmëron veprime për të korrigjuar disbalanset aktuale në përbërjen e administratës publike, përmes rekrutimit të **komuniteteve joshumicë/ të nënpërfaqësuar** në nivel lokal dhe qendror.<sup>36</sup>

33 Marrëveshja Kornizë, neni 6 Edukimi dhe Përdorimi i Gjuhëve, pika 6.4, 6.5, 6.6, 6.7 dhe 6.8. Shih po ashtu: Aneksi A, Amendamentet Kushtetuese, neni 7.

34 Marrëveshja Kornizë, neni 6 Edukimi dhe Përdorimi i Gjuhëve, pika 6.1, 6.2 dhe 6.3. Shih edhe Aneksi A, Amendamentet Kushtetuese, neni 48, pika 4.

35 Aneksi A, Amendamentet Kushtetuese, neni 19.

36 Marrëveshja Kornizë, neni 4 Jodiskriminimi dhe Përfaqësimi i Barabartë, pika 4.1, 4.2 dhe 4.3.

Marrëveshja thotë se do t'i kushtohet vëmendje që **shërbimet policore** të reflektojnë përbërjen dhe shpërndarjen e popullatës në Maqedoni. Për këtë, palët zotohen të sigurojnë 500 zyrtarë të rinj policorë nga **komunitetet joshumicë** që do të vendosen në vendet ku jetojnë këto komunitete. Po ashtu, për zbatimin e këtij zotimi dhe për përzgjedhjen e trajnimitin e kandidatëve, parashihet të ftohet për mbështetje bashkësia ndërkombëtare. Marrëveshja parasheh që shefat lokalë të policisë të zgjedhen nga këshillat komunalë, por nga një listë e kandidatëve të propozuar nga Ministria e Brendshme, e cila ka të drejtën t'i shkarkojë ata në përputhje me ligjin. Lista nuk duhet të ketë më pak se tre kandidatë, ku të paktën njëri duhet të jetë prej **komunitetit shumicë** në komunë.<sup>37</sup>

Marrëveshja parasheh **procedura speciale parlamentare**, ku kërkohet shumica e votave të numrit total të përfaqësuesve që pretendojnë se u takojnë **komuniteteve joshumicë** (2/3), për të zgjedhë: një të tretën e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese; tre prej anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, dhe Ombudspersonin. Kjo shumicë nevojitet edhe për ndryshimin e disa amendamenteve kushtetuese dhe të vetëqeverisjes lokale në: kulturë, përdorim të gjuhës, edukim, dokumentacion personal, përdorim të simboleve, ligje për financa lokale, për zgjedhje lokale, për qytetin e Shkupit dhe për kufijtë e komunave, rishikimi i të cilave parashihej me ndodhë pas regjistrimit të popullsisë.<sup>38</sup>

Palët e Marrëveshjes së Ohrit ftojnë bashkësinë ndërkombëtare për të lehtësuar, monitoruar dhe asistuar në zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje, si dhe që koordinator i këtyre përpjekjeve të jetë Bashkimi Europian.<sup>39</sup> Palët, po ashtu, e ftojnë bashkësinë ndërkombëtare, të rrisë mbështetjen për projektet në fushën e mediave për të forcuar radion, televizionin dhe median e shtypur, përfshi median në gjuhën shqipe dhe atë multietnike, por edhe të shtojë programet trajnuese profesionale për media për anëtarët e komuniteteve jo-shumicë në Maqedoni.<sup>40</sup> Në rast të mosmarrëveshjeve për zbatimin e këtyre dispozitave, parashihet ndërhyrje e **Komitetit për Marrëdhënie**

37 Marrëveshja Kornizë, neni 3 Zhvillimi i Qeverisjes së Decentralizuar, pika 3.3. Shih edhe: Aneksi C Implementimi dhe Masat e Ndërtimit të Besimit, neni 5 Jodiskriminimi dhe Përfaqësimi i Barabartë, pika 5.2 dhe 5.3. Po ashtu shih edhe: Ankesi B Ndryshimet Legjislative, neni 4 Ligjet Lidhur me Policinë e Vendosur në Komuna.

38 Marrëveshja Kornizë, neni 5 Procedura Speciale Parlamentare, 5.1 dhe 5.2. Shih edhe Aneksi A, Amendamentet Kushtetuese, neni 114.

39 Aneksi C Implementimi dhe Masat e Ndërtimit të Besimit, neni 1 Mbështetja Ndërkombëtare, pika 1.1.

40 Aneksi C Implementimi dhe Masat e Ndërtimit të Besimit, neni 6 Kultura, Edukimi dhe Përdorimi i Gjuhëve, pika 6.1.

**mes Komuniteteve**, i cili përbëhet nga deputetë të të gjitha komuniteteve, duke dhënë vlerësime e propozime për zgjidhje të problemeve, të cilat duhet t'i marrë në konsideratë Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.<sup>41</sup>

---

41 Aneksi A, Amendamentet Kushtetuese, neni 69 dhe 78.

## 4.2. Statuti i Krahinës Autonome të Vojvodinës 2008

Statuti i Krahinës Autonome të Vojvodinës thotë se Vojvodina është **krahinë autonome e qytetarëve** që jetojnë në territorin e saj dhe **pjesë e pandashme e Sërbisë**. Të gjithë qytetarët që jetojnë në Vojvodinë kanë të drejta të barabarta pa dallim dhe çdo formë e diskriminimit mbi çfarëdo baze është e ndaluar. Territori i Vojvodinës përbëhet nga **njësitë lokale të vetëqeverisjes** në kuadër të **zonave gjeografike** të veta (Bačka, Banat dhe Sirmia) dhe nuk mund të ndryshohet pa pëlqimin e shumicës së qytetarëve të saj me të drejtë vote, të shprehur në referendum. Vojvodina synon promovimin e këtyre parimeve: **multilingualizmi, multikulturalizmi dhe multikonfesionalizmi**<sup>42</sup>.

**Komunitetet nacionale** në territorin e Vojvodinës (sërbë, hungarezë, sllovakë, kroatë, malazezë, rumunë, romë, bunjevccë, rusinë, maqedonë dhe të tjerë) janë të barabarta të ushtrojnë të drejtat e tyre dhe gëzojnë **mbrojtje speciale** dhe të gjitha **të drejtat e garantuara për pakicat kombëtare** dhe **personat që u përkasin pakicave kombëtare**. Kur jemi të mbrojtja speciale, duhet thënë se përveç komuniteteve nacionale, mbrojtje speciale gëzojnë edhe: **toka e punëshme, bukuritë natyrore, trashëgimia shkencore, kulturore dhe historike**. Sidoqoftë, në trupat dhe organizatat krahinore, personat që u përkasin komuniteteve nacionale duhet të jenë të përfaqësuar në përputhje me numrin e popullatës që përbëjnë në krahinë. Për më shumë, Kuvendi dhe Qeveria e kanë për obligim të ndërmarrin masa speciale për ta arritë këtë **përfaqësim proporcional**.<sup>43</sup>

Secili **komunitet nacional** në Vojvodinë ka të drejtë të ketë Këshillin Kombëtar dhe nëpërmjet tij të ushtrojë një formë të autonomisë, të themelojë institucione, të vendosë ose të marrë pjesë në mënyrë të pavarur në procesin e vendim-marrjes për çështjet që kanë të bëjnë me: **edukim, kulturë dhe përdorim të gjuhëve**. Krahina Autonome e Vojvodinës mund të delegojë kryerjen e detyrave të caktuara të këta Këshilla Kombëtarë në fushat e lartpërmendura.<sup>44</sup>

Vojvodina ka status të entitetit legal dhe ka institucione legjislative e ekzekutive: **Kuvendin** që mund të ndërmarrë aktivitete në kuadër të kompetencave që ka krahina, si dhe **Qeverinë** e cila është ekzekutuese e vendimeve të Kuvendit. Në fushën e gjykatave, Vojvodina mund të propozojë një rrjet të gjykatave që

42 Statuti i Krahinës Autonome të Vojvodinës, Kapitulli I Dispozitat e Përgjithshme, neni 1 dhe 3; dhe Kapitulli II Ushtrimi i të Drejtave të Njeriut dhe të Minoriteteve, neni 20.

43 Statuti i Krahinës Autonome të Vojvodinës, Kapitulli I Dispozitat e Përgjithshme, neni 6 Barazia Kombëtare dhe Kapitulli II Ushtrimi i të Drejtave të Njeriut dhe të Minoriteteve, neni 24, Përfaqësimi Proporcional.

44 Statuti i Krahinës Autonome të Vojvodinës, Kapitulli II Ushtrimi i të Drejtave të Njeriut dhe të Minoriteteve, neni 25 Autonomia e Komuniteteve Nacionale.

funksionojnë në territorin e krahinës. Vojvodina ka edhe **administratën krahinore** dhe **ombudspersonin krahinor**, i cili ka për detyrë të mbrojtë të drejtat e njeriut. Ajo ka edhe simbolet e veta, kryeqytetin si qendër administrative, dhe, madje mund ta themelojë edhe Akademinë e Shkencave dhe të Arteve.<sup>45</sup> Duhet shtuar edhe se Kuvendi duhet të marrë vendim me 2/3 e deputetëve: për të amenduar statutin; për ta miratuar vendimin për implementimin e statutit dhe për zgjedhjen dhe lirin nga detyra të ombudspersonit krahinor.<sup>46</sup>

Kompetencat e Krahinës Autonome të Vojvodinës janë në këto fusha: planifikim hapësinor, zhvillim regjional, agrokulturë, zhvillim rural, menaxhim të ujit, pyje, gjëti, peshkim, turizëm, industri të ushqimit, mbrojtje të mjedisit, industri dhe zëjtari, transport rrugor, ujqor dhe hekurudhor dhe rregullim të rrugëve, organizim të panajreve dhe ngjarjeve të tjera ekonomike, edukim, sport dhe kulturë, shkencë dhe zhvillim teknologjik, mbrojtje shëndetësore e sociale, informim publik, zhvillim infrastrukturor dhe investime kapitale.<sup>47</sup>

Vojvodina duhet me pasë burime të drejtpërdrejta të të ardhurave për **financimin** e aktiviteteve që janë në kuadër të kompetencave të saj. Përveç që buxheti i Vojvodinës duhet me marrë **të paktën 7% të buxhetit të Republikës së Serbisë**,<sup>48</sup> Vojvodina duhet t'i sigurojë të ardhurat e veta edhe përmes: mbledhjes së taksave, të ardhurave vjetore nga prona kur është titullare e saj, pjesëmarrjes në të ardhura të ndërmarrjeve publike dhe institucioneve, kredive publike, kredive komerciale, bartjes së resurseve buxhetore, të donacioneve e granteve dhe të burimeve të tjera.<sup>49</sup>

Në kuadër të detyrave dhe të drejtave të tyre, të gjithë mekanizmat krahinorë kanë për obligim të kujdesen dhe ta ndihmojnë mbrojtjen dhe zhvillimin e **multilingualizmit** dhe të mbështesin respektin reciprok, si dhe familjarizimin me **gjuhë dhe religjione** të ndryshme në Vojvodinë.<sup>50</sup> Sa i takon religjionit, Vojvodina ka kompetenca të bashkëpunojë me kishat dhe komunitetet religjioze në territorin e krahinës, ndërsa kur bëhet fjalë për gjuhët, status të **gjuhës zyrtare** në Vojvodinë kanë, përveç gjuhës serbe, edhe gjuha hungareze, sllovaqe, rumune, kroate dhe rusine. Në fushën e

45 Për autoritetet e Krahinës Autonome të Vojvodinës, shih kapitullin IV të Statutit, konkretisht: Pjesa 1 Kuvendi i Vojvodinës, Pjesa 2 Qeveria e Vojvodinës, Pjesa 3 Administrata Krahinore dhe Pjesa 4 Ombudspersoni Krahinor. Shih edhe nenin 17 të Statutit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Vojvodinës.

46 Statuti i Krahinës Autonome të Vojvodinës, Kapitulli IV Autoritetet e Vojvodinës, Pjesa 1 Kuvendi i Vojvodinës, neni 41 Metodrat e Vendimmarrjes.

47 Statuti i Krahinës Autonome të Vojvodinës, neni 29.

48 Statuti i Krahinës Autonome të Vojvodinës, Kapitulli 5 Financimi, Buxheti i Krahinës Autonome, neni 62.

49 Statuti i Krahinës Autonome të Vojvodinës, Kapitulli 5 Financimi, Të Ardhurat e Krahinës Autonome, neni 63.

50 Statuti i Krahinës Autonome të Vojvodinës, Kapitulli I Dispozitat e Përgjithshme, neni 7 Multikulturalizmi dhe Interkulturalizmi.

**informimit publik**, Vojvodina ka të drejtë që të definojë interesin publik të qytetarëve të krahinës në fushën e informimit publik dhe radio-difuzionit dhe më specifikisht të rregullojë kushtet dhe mënyrën e performimit të aktiviteteve të Shërbimit Radio Difuziv Krahinor. Po ashtu, Vojvodina duhet të sigurojë punën e mediave relevante për krahinën në gjuhët e komuniteteve nacionale që përbëjnë minoritetet numerik në popullatën e tërësishme të krahinës.<sup>51</sup>

Në fushën e edukimit, **në përputhje me Kushtetutën e Serbisë**, marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare si dhe me qëllim të sigurimit të interesit publik, Vojvodina ka të drejtë t'i rregullojë çështjet relevante për krahinën në fushën e **edukimit parashkollor, elementar dhe të lartë**, por edhe të garantojë ushtrimin e të drejtës për edukim në gjuhë amtare për personat që u përkasin komuniteteve nacionale në të gjitha nivelet e edukimit.<sup>52</sup> Në shëndetësi, njësoj **në përputhje me Kushtetutën e Serbisë** dhe marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare, Vojvodina ka të drejtë që të rregullojë çështjet relevante që kanë të bëjnë me **kujdesin shëndetësor, mbrojtjen shëndetësore, sigurimin shëndetësor dhe shërbimet shëndetësore e farmaceutike**. Po ashtu, në këtë fushë, Vojvodina ka të drejtë që të themelojë **institucione për mbrojtje shëndetësore sekondare dhe terciare**.<sup>53</sup>

Për sa u takon raporteve mes Republikës së Serbisë dhe Krahinës Autonome të Vojvodinës parashihet që të mund të themelohet një komitet i përzier mes këtyre dy entiteteve. Vojvodina ka të drejtë **të bashkëpunojë me komunitetet territoriale dhe format e tjera të autonomive në vendet e tjera** në kuadër të politikës së jashtme të Republikës së Serbisë dhe **të bëjë marrëveshje ndër-regionale** në fushat që janë kompetencë e saj, duke pasë parasysh integritetin territorial dhe sistemin legal të Serbisë.<sup>54</sup> Vojvodina mund të themelojë zyrat përfaqësuese në regjionet europiane për t'i promovuar kapacitetet në ekonomi, shkencë, edukim dhe turizëm dhe të jetë anëtare e asociacioneve europiane dhe ndërkombëtare të regjioneve.

Sa i përket mbrojtjes së autonomisë, në kuadër të të drejtave të veta, Kuvendi dhe Qeveria e Vojvodinës kanë të drejtë të ankohen në Gjykatën Kushtetuese nëse ndonjë akt ose veprim shtetëror pengon ushtrimin e kompetencave të krahinës. Vojvodina ka të drejtë që të nisë procedurë për të shqyrtuar kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e ndonjë ligji ose akti të Serbisë, i cili dhunon autonominë e Vojvodinës.<sup>55</sup>

51 Statuti i Krahinës Autonome të Vojvodinës, Kapitulli III Kompetencat e Vojvodinës, neni 29, pika 12.

52 Statuti i Krahinës Autonome të Vojvodinës, Kapitulli III Kompetencat e Vojvodinës, neni 29, pika 9.

53 Statuti i Krahinës Autonome të Vojvodinës, Kapitulli III Kompetencat e Vojvodinës, neni 29, pika 11.

54 Statuti i Krahinës Autonome të Vojvodinës, neni 16 Bashkëpunimi Ndër-regional. Shih edhe: Kushtetuta e Republikës së Serbisë, neni 181 Bashkëpunimi i Krahinave Autonome dhe Njësi të Vetëqeverisjes Lokale.

55 Statuti i Krahinës Autonome të Vojvodinës, Kapitulli I Dispozita të Përgjithshme, neni 18 Mbrojtja





## 5. AUTONOMITË NË EUROPË

### 5.1. Statusi i Autonomisë i Tirolit të Jugut 1972

Në bazë të Kushtetutës, Republika e Italisë ndahet në: rajone, krahina dhe komuna. Tirol i Jugut është **rajon** që, si njësi territoriale autonome me kompetenca në përputhje me kushtetutën, përfshin dy **krahina** (Trento dhe Bolcano) dhe përbën pushtet autonom me autoritet juridik brenda **unitetit politik** të Italisë, ku të gjithë qytetarët janë të barabartë, pa marrë parasysh përkatësinë **gjuhësore** dhe veçoritë **kulturore e etnike**. Rajoni dhe krahinat kanë flamujt dhe stemat e veta.<sup>56</sup>

Organet Rajonale janë: **Këshilli Rajonal** me kompetenca legislative; **Këshilli Ekzekutiv Rajonal**, që është trup ekzekutiv për zbatimin e ligjeve në rajon; dhe **Kryetari i Këshillit Ekzekutiv**, i cili e përfaqëson Rajonin. Statuti i rajonit Tirol i Jugut miratohet nga Këshilli Rajonal, i cili mandatin e vet e plotëson prej dy kuvendeve të barabarta të cilat mbahen alternativisht në dy krahinat: Trento dhe Bolcano. Anëtarët e Këshillit Rajonal e japin betimin e besnikërisë ndaj Republikës dhe të garantojnë se detyrën e vet do ta kryejnë në të mirë të **shtetit dhe rajonit**. Gjysmën e mandatit Kryetari i Këshillit Rajonal zgjedhet nga radhët e këshilltarëve italianë, kurse nënkryetari nga këshilltarët gjermanë; në gjysmën tjetër është e anasjellta. Këshilli Rajonal mund të shpërndahet për shkak të shkeljes së kushtetutës dhe të ligjeve, për shkak të sigurisë kombëtare, ose nëse nuk e përmbush kërkesën e Qeverisë për ta shkarkuar Këshillin Ekzekutiv dhe Kryetarin e Këshillit Ekzekutiv kur këta bëjnë shkelje të ngjashme. Pezullimin e Këshillit Rajonal mund ta bëjë me dekret Presidenti i Italisë.<sup>57</sup>

Në përputhje me Kushtetutën e Italisë, detyrimet ndërkombëtare dhe interesin nacional, **rajon** i Tirolit i Jugut ka kompetenca legislative në këto fusha: rregullimi i organeve të rajoneve dhe i pozitës së të punësuarve në to; rregullimi i pozitës së organeve pararajonale; kufijtë e komunave; ekspropriimi me interes publik, duke përfshi punët që janë në kompetencën dhe nën drejtimin e shtetit; formimi dhe mbajtja e librave të kadastrit; shërbimet e zjarrfikësve; rregullimi i punës së agjencive të ngarkuara për shëndetësi dhe spitale; rregullimi i punës së odave ekonomike; zhvillimi i shoqatave kooperative dhe mbikëqyrja e punës së kooperativave; kontributi

56 Statusi i Autonomisë i Tirolit të Jugut, Kapitulli I Dispozitat e Përgjithshme, neni 1, 2 dhe 3.

57 Kreu II, Organet Rajonale e Krahinore, Kapitulli I Organet Rajonale dhe Kapitulli II Organet Krahinore.

për përparime me anë të punëve publike të cilat i organizojnë shërbimet e tjera në territorin e rajonit.<sup>58</sup>

Kushtetuta e Italisë precizon se **rajonit** ka të drejtë të nxjerrë ligje për: organizimin e zyrave lokale dhe të trupave administrative, kufijtë e qyteteve, policinë urbane dhe rurale, panaiet dhe tregjet, manifestimet publike bamirëse, ndihmat shëndetësore spitalore, arsimimin e orientuar të artistëve dhe të zanatçinjve dhe ndihmat shkollore, muzetë dhe bibliotekat, urbanizmin, turizmin dhe industrinë hoteliere, tramvajet dhe shërbimet e autobusëve, rrugët, ujësjellësin dhe punët publike, komunikacionin e liqejve dhe të porteve, ujërat minerale dhe banjat, gurthyerjet dhe xehroret, gjuetinë, peshkimin në liqene e lumenj, bujqësinë, pylltarinë dhe zejtari.<sup>59</sup>

Sa u takon raporteve mes **shtetit** dhe **rajonit**, **shteti** emëron nga një përfaqësues të plotfuqishëm për dy **krahinat** e **rajonit** që bashkërendon ushtrimin e funksioneve të **shtetit** në **rajon** dhe mbikqyr punën e kancelarive, përpos atyre që merren me administrimin e drejtsisë dhe të mbrojtjes. Përgjegjësi e përfaqësuesit të plotfuqishëm të shtetit është edhe sigurimi i mbajtjes së rendit publik dhe për këtë ai mund t'i shfrytëzojë organizatat shtetërore dhe frocat e rendit dhe të kërkojë përdorimin e forcave të tjera të armatosura.<sup>60</sup> Përfaqësuesit e plotfuqishëm kanë kompetenca të miratojnë secilin ligj që e miraton Këshilli Rajonal, e në qoftë se ndonjë ligj i tejkalon kompetencat ose bie ndesh me interesat e kombit ose të ndonjë rajoni tjetër, kthehet mbrapsht dhe nëse Këshilli Rajonal e miraton prap, atëherë, kërkohet mendimi i Gjykatës Kushtetuese.

Duhet thënë se rrugët, autostrada, hekurudha dhe ujësjellësi në rajon janë në pronësi të Rajonit. Pasuria shtetërore në rajon bartet në pronësi të rajonit, kurse pasuria rajonale e cila nuk ka pronar bëhet pronësi e rajonit. Pyjet shtetërore në rajon, minierat, gurëthyerjet dhe xehroret, ndërtesat që shfrytëzohen për zyra publike dhe pronësia tjetër e destinuar për shërbimin publik rajonal paraqesin pasuri të patjetërsueshme të rajonit.<sup>61</sup>

Lidhur me **financimin**: **rajonit** financohet nga të ardhurat nga tatimi në pronën që gjendet në territorin e rajonit, por i takojnë edhe këto kuota: 9/10 nga tatimet mbi trashëgiminë dhe donacionet; 2/10 e tatimit të përgjithshëm mbi të ardhurat në shkallë rajonale; dhe 90% e të ardhurave nga lotaria; **krahinat** financohen nga të ardhurat prej tatimit mbi shpenzimin e gazit dhe të energjisë që mblidhen në krahina. Po ashtu, 90% e tatimit mbi të ardhurat të grumbulluara në territoret e krahinave u

58 Kapitulli II Kompetencat e Pushtetit Autonom, neni 4.

59 Kushtetuta e Republikës së Italisë, Pjesa V, Rajonet, Krahinat dhe Komunat, neni 117.

60 Kapitulli VII, Marrëdhëniet mes Shtetit, Rajonit dhe Krahinës, neni 87 dhe 88.

61 Kapitulli V, Pronësia dhe Pasuria e Rajoneve dhe e Krahinave, neni 66 dhe 67.

takon krahinave.<sup>62</sup>

Në krahinën Bolcano në entet parashkollore dhe në **arsimin fillor e të mesëm**, mësimi zhvillohet në **gjuhën italiane dhe gjermane**, d.m.th. në gjuhët amtare të nxënësve nga mësues që flasin gjuhë të njëjtë amtare. Nga klasa e tretë e shkollës fillore është i obligueshëm edhe mësimi i gjuhës tjetër. Për **themelimin e universitetit në Krahinë**, Italia duhet të marrë pëlqimin e **rajonit** dhe të **krahinës**.<sup>63</sup>

Në kuadër të **rajonit** si gjuhë zyrtare njihen në mënyrë të barabartë **gjuha gjermane** dhe **italiane**, kurse kjo e fundit është gjuhë zyrtare në krejt territorin e Italisë. Popullata gjermanofone e **krahinës** Bolcano ka të drejtë të shfrytëzojë gjuhën e vet në organet gjyqësore, në organet e shërbimeve publike në krahinë dhe në organet rajonale. Përveç nëse normat udhërojnë që të përdoren të dy gjuhët, në dokumentet e destinuara për qytetarët në përgjithësi është i lejueshëm përdorimi i njëres apo i gjuhës tjetër. Në normat ushtarako-juridike shfrytëzohet gjuha italiane. Në krahinën Bolcano shërbimet publike duhet të përdorin emrat gjermanë të vendeve duke marrë parasysh popullatën gjermanofone.<sup>64</sup>

Sa i takon gjyqësisë, ekziston **Gjykata Rajonale Administrative** me degët autonome për krahinën Bolcano, anëtarët e të cilës duhet t'u takojnë me numër të barabartë të dy bashkësive kryesore gjuhësore. Gjyqtarët italianë dhe gjermanë alternohen në periudhën e njëjtë kohore në vendin e kryetarit të degës. Kryetari i degës zgjidhet me dekretin e Kryetarit të Republikës, në bazë të rekomandimit të Kryeministrit, dhe ka votë vendimtare kur krijohet pozicioni pat në votimet e gjyqtarëve të të dy bashkësive gjyqësore, përveç kur paraqitet aneksi kundër dispozitave administrative të dëmshme për barazinë e bashkësive gjuhësore dhe të procedurës për akordimin e buxhetit rajonal e krahinor. Personat që dëshirojnë të emërohen për gjyqtarë, zëvendës të gjyqtarëve, ndihmës dhe praktikantë, si dhe për udhëheqës të kancelarive, duhet të flasin italisht dhe gjermanisht shkëlqyeshëm.<sup>65</sup> Ligjet e Republikës së Italisë mund të kontestohen nga organet rajonale dhe krahinore në Gjykatën Kushtetuese për shkak të shkeljes së Statutit të Tirolit të Jugut ose parimit të mbrojtjes së pakicave gjuhësore. Po ashtu, organet rajonale e krahinore mund të kontestojnë ligjet e njëra-tjetrës.<sup>66</sup>

62 Kapitulli VI, Financat Rajonale dhe Krahinore, sidomos nenet: 69, 70, 71, 75, 76 dhe 77.

63 Kapitulli IV, Dispozitat e Përbashkëta për Rajonin dhe Krahinat, neni 19.

64 Kapitulli XI Shfrytëzimi i Gjuhës Gjermane dhe Ladine, neni 99, 100 dhe 101.

65 Kapitulli IX, Organet Gjyqësore.

66 Kapitulli IX, Kontrolli i Gjyqit Kushtetues, neni 97 dhe 98.

## 5.2. Statuti i Autonomisë i Katalonisë 2006

Katalonia, si komunitet autonom, ushtron vetëqeverisje në përputhje me Kushtetutën e Spanjës dhe Statutin e Autonomisë të Katalonisë. Këto dy dokumente përbëjnë bazën e sistemit institucional të Katalonisë rreth të cilit organizohet politikisht vetëqeverisja e Katalonisë. Ky sistem quhet *Generalitat* dhe përbëhet nga Parlamenti, Presidenca dhe Qeveria. Marrëdhëniet mes *Generalitat* dhe Spanjës bazohen në parimin e lojalitetit reciprok institucional. Katalonia ka hapsinën e vet të referencës politike e gjeografike në Spanjë dhe në Bashkimin Europian. Katalonia promovon ushtrimin e plotë të drejtave dhe lirive të njohura nga Statuti, Kushtetuta e Spanjës dhe dokumentet ndërkombëtare në lidhje me këtë. Po ashtu, Katalonia promovon lirinë e drejtësinë dhe pjesëmarrjen e të gjithë njerëzve në jetën politike, ekonomike, kulturore dhe shoqërore, kurse institucionet e saj janë sekulare. Flamuri dhe himni i Katalonisë janë simbole kombëtare të Katalonisë. Flamuri duhet të jetë i pranishëm në ndërtesat publike dhe gjatë aktiviteteve zyrtare që mbahen në Kataloni.

Siç u përmend më sipër, *Generalitat* përbëhet nga Parlamenti, Presidenca dhe Qeveria. **Parlamenti** përfaqëson qytetarët e Katalonisë dhe ushtron pushtet legjislativ, miraton buxhetin dhe kontrollon e promovon veprimet politike e qeveritare. Parlamenti, si vend ku shprehet pluralizmi dhe debati politik, është i padhunueshëm dhe ka autonomi organizative, financiare dhe administrative. Parlamenti cakton senatorët që përfaqësojnë Kataloninë në Senat, të cilët duhet të jenë në proporcion me numrin e anëtarëve të secilit grup parlamentar.<sup>67</sup> **Presidenti** është përfaqësuesi më i lartë i *Generalitat* dhe drejtues i veprimeve të Qeverisë. Presidenti caktohet nga Mbreti dhe zgjedhet nga Parlamenti. Në emër të Mbretit ai ka kompetenca, mes tjerash, për të aprovuar ligjet.<sup>68</sup> **Qeveria** ushtron funksione ekzekutive në përputhje me Statutin e Katalonisë dhe Kushtetutën e Spanjës dhe përbëhet nga Presidenti, Ministri i Parë (i cili caktohet nga Presidenti) dhe ministrat.<sup>69</sup>

Perveç **Administratës Publike**, institucion i rëndësishëm i Katalonisë është edhe **Këshilli për Garancione Statutore**, që ka për detyrë të sigurojë se rregulloret e

67 Kaptina II, Institucionet, Kapitulli I Parlamenti, neni 55 Dispozita të Përgjithshme, neni 58 Autonomia Parlamentare dhe neni 61 Funksionet.

68 Kaptina II, Institucionet, Kapitulli II Presidenti, neni 67 Zgjedhja, Nominimi, Statusi Personal, Ndërprerja dhe Kompetencat.

69 Kaptina II, Institucionet, Kapitulli III Qeveria dhe Administrata e Generalitat-it, seksioni 1, neni 68 Qeveria, neni Funksionet, Përbërja, Organizimi dhe Ndërprerja, dhe neni 69 dhe 70.

*Generalitat* janë në përputhje me Statutin e Katalonisë dhe Kushtetutën e Spanjës. Ky këshill përbëhet nga juristë me kompetencë që caktohen nga Presidenti i *Generalitat*, dy të tretat e të cilëve nominohen nga Parlamenti me shumicë prej 3/5 të deputetëve, kurse pjesa tjetër nominohet nga Qeveria.<sup>70</sup> Tjetër institucion i rëndësishëm është edhe **Ombudspersoni** që ka për funksion të përkujdeset dhe t'i mbrojtë të drejtat dhe liritë e garantuara me Statut dhe Kushtetutë dhe për këtë duhet të bashkëpunojë me Ombudspersonin e Spanjës. Institucione të rëndësishme janë edhe Zyra e Auditorit dhe Autoriteti Katalon i Transmetimit.<sup>71</sup>

Kompetencat e *Generalitat* janë të ndara në: kompetenca ekskluzive, kompetenca të ndara dhe kompetenca ekzekutive. *Generalitat* ka **kompetenca ekskluzive** në këto fusha: bujqësi, ujë, asociacione dhe fondacione, gjueti, peshkim dhe aktivitete detare, kurisme bankare, tregti dhe panairë tregtare, konsultim popullor, çështje konsumatori, kooperativa dhe ekonomi shoqërore, sigurime, kulturë, edukim, mbrojtje civile, sport, statistikë, punësim publik, strehim, imigrim, industri, transport, lojëra fati, rini, gjuhë, punë publike, planifikim urban dhe bregdetar, organizim të administratës, organizim territorial, politika gjinore, promovim dhe mbrojtje e konkurrencës, reklama, hulumtim, zhvillim dhe inovacion teknologjik, qeverisje lokale, marrëdhënie me entitetet religjioze, kujdes shëndetësor, shërbime sociale, transport, turizëm, universitete; kurse **kompetenca të ndara** në: energji dhe miniera, ambient, media, planifikim, organizim dhe promovim i aktiviteteve ekonomike dhe siguri shoqërore; ndërsa **kompetenca ekzekutive** në: regjistrat publikë dhe çështje noteriale, pronësi intelektuale, mbrojtje e të dhënave personale dhe sistemin e burgjeve.<sup>72</sup>

Organizimi i **vetëqeverisjes lokale** në Kataloni bazohet në *komuna* e në *vegueries*, në përputhje me Kartën e Vetëqeverisjes Europiane, me kompetenca në këto fusha: planifikim urban, mbrojtje civile, edukim të fëmijëve, transport publik, promovim të aktiviteteve ekonomike, turizëm, mbrojtje të ambientit, sport, shërbime të kujdesit primar, shërbime të telekomunikacionit, e me radhë. Komunitat kanë të drejtë të lidhen me komunitat tjera dhe të bashkëpunojnë me njëra tjetrën dhe me trupat tjerë publik duke hy në marrëveshje dhe krijuar asociacione ose entitete supra-komunale të vetëqeverisjes lokale.<sup>73</sup>

**Gjuhë zyrtare** e Katalonisë është gjuha katalone, bashkë me gjuhën spanjolle që është gjuhë zyrtare e Spanjës. Gjuha katalone përdoret në trupat e administratës publike,

70 Kapitulli 5 Institucionet tjera të *Generalitat*-it, seksioni 1, Këshilli për Garancione Statutore, neni 76 Funksionet dhe neni 77 Përbërja dhe Funksionimi.

71 Kapitulli 5 Institucionet tjera të *Generalitat*-it, seksioni 2, Ombudspersoni, neni 78 Funksionet dhe Marrëdhëniet me Institucionet tjera të Ngjashme dhe neni 79 Përcaktimi dhe Statusi i Ombudspersonit.

72 Kapitulli IV Pushtetet, Kapitulli I Llojet e Kompetencave, neni 110 Kompetencat Ekskluzive, neni 111 Kompetencat e Ndara, neni 112 Kompetencat Ekzekutive.

73 Kapitulli VI Vetëqeverisja Lokale, Seksioni I Organizimi Territorial Lokal, Seksioni II Komunitat, dhe seksioni III *Vegueries*.

në mediat publike dhe në sistemin arsimor. Qytetarët e Katalonisë kanë të drejtë dhe detyrë t'i dinë këto gjuhë. Të punësuarit në të gjitha institucionet e Katalonisë duhet të kenë njohuri adekuatë dhe të mjaftueshme të gjuhëve zyrtare. Generalitat dhe Spanja duhet t'ia sigurojnë gjuhës katalone statusin zyrtar në Bashkimin Europian dhe praninë dhe përdorimin në organizata ndërkombëtare.<sup>74</sup> Etiketat, ambalazhi dhe udhëzimet për përdorimin e produkteve që shpërndahen në Kataloni të jenë edhe në gjuhën katalone. Gjuha katalone duhet të përdoret për edukim universitar dhe jo-universitar. Të dy gjuhët duhet të prezantohen në mënyrë të barabartë në programe pasi që nxënësit duhet t'i dinë të dy gjuhët. Nxënësit nuk duhet të ndahen në klasë të ndryshme duke u bazuar në gjuhë. Studentët dhe profesorët kanë të drejtë të shprehen në gjuhën zyrtare që ata e zgjedhin.<sup>75</sup>

Generalitat ka pushtet ekskluziv në **edukimin jo-universitar** që nënkupton: programimin e mësimdhënies, organizimin e sektorit të edukimit, vendosjen e programeve të përshtatshme mësimore, përfshi planifikimin programor.<sup>76</sup> Në **edukimin universitar** *Generalitat* ka pushtet ekskluziv në planifikim dhe koordinim të sistemit universitar, në marrjen e vendimit për të krijuar universitete publike dhe për të autorizuar universitetet private, por ka kompetenca edhe në aprovimin e statuteve të universiteteve.<sup>77</sup>

Autoritet publike e kanë për obligim të promovojnë kushtet që garantojnë të drejtën për informim nga **mediat**, të cilat duhet të respektojnë pluralizmin politik, shoqëror, kulturor dhe fetar. *Generalitat* ka kompetenca **ekskluzive** sa i takon organizimit të shërbimeve të transmetuesit publik, kurse kompetenca **të ndara** sa i takon rregullimit dhe kontrollit të shërbimeve të transmetimit. *Generalitat*, po ashtu, ka për detyrë të promovojë pluralizmin gjuhësor dhe kulturor të Katalonisë në **media**.<sup>78</sup>

*Generalitat* ka kompetenca ekskluzive sa i takon entiteteve **religjioze** që kryejnë aktivitetet e tyre në Kataloni, e kjo nënkupton rregullimin dhe vendosjen e bashkëpunimit dhe mekanizmave bashkëpunues për të kryer aktivitetet e tyre. *Generalitat*, përveç që mund të marrë pjesë në menaxhimin e Regjistrisë Shtetërore të Entiteteve Religjioze, mund të vendosë marrëveshje bashkëpunimi me komunitetet religjioze, por edhe ka për detyrë që të promovojë, zhvillojë dhe ekzekutojë marrëveshjet e nënshkruara mes Shtetit dhe kishave dhe komuniteteve religjioze të regjistruara.<sup>79</sup>

74 Kaptina Paraprake, neni 6 Gjuha e Katalonisë dhe Gjuhët Zyrtare, pika 1, 2, 3, 4 dhe 5. Shih edhe Kapitullin 3 Të Drejtat dhe Obligimet Gjuhësore.

75 Kapitullin 3 Të Drejtat dhe Obligimet Gjuhësore, neni 35 Të Drejtat Gjuhësore në Fushën e Edukimit.

76 Kaptina IV Kompetencat, Kapitulli II Çështje të Kompetencave, neni 131 Edukimi, pika 1, 2 dhe 3.

77 Kaptina V, neni 172.

78 Kaptina I Të Drejtat, Obligimet dhe Parimet Qeverisëse, Kapitulli V Parimet Qeverisëse, neni 52, dhe Kaptina V, neni 146 ARTICLE 146. Mediat dhe Shërbimet Audiovizive.

79 Kaptina V, neni 161 Marrëdhëniet me Entitetet Religjioze.

Katalonia ka kompetenca ekskluzive në **kujdesin shëndetësor** dhe **shëndetin publik** sa i takon organizmit, funksionimit të brendshëm, vlerësimit, inspektimit dhe kontrollit të qendrave dhe shërbimeve shëndetësore. Ndërsa, kompetenca të ndara në mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit publik në të gjitha fushat, por edhe në: klasifikimin, planifikimin, përcaktimin dhe ekzekutimin e shërbimeve shëndetësore publike, sociale dhe mentale në të gjitha nivelet dhe për të gjithë qytetarët. Planifikimi i resurseve në kujdesin shëndetësor dhe koordinimi i aktiviteteve të sistemit të kujdesit shëndetësor publik me atë privat dhe akreditimi, evaluimi i qendrave të kujdesit shëndetësor dhe pjesëmarrja në programt trajnuese bëjnë pjesë në kompetencat e ndara. Duhet thënë se Katalonia merr pjesë në planifikimin dhe koordinimin shtetëror në fushën e kujdesit shëndetësor dhe shëndetit publik.<sup>80</sup>

**Financimi** i Katalonisë, sikurse edhe i komuniteteve tjera autonome, bëhet përmes të tatimet që mbledhen në territorin e Katalonisë si tatimi në të ardhura, tatime prej të cilave Spanja heqë dorë **totalisht** dhe tatime prej të cilave heqë dorë **pjesërisht**, pastaj prej transfereve dhe alokimeve nga Spanja, prej pagesave të shërbimeve publike, mandej nga kreditë, gjobat, e edhe nga donacionet prej BE-së, e kështu me radhë.<sup>81</sup> Sa i takon bashkëpunimit mes Spanjës dhe Katalonisë në këtë fushë, ekziston një trup i përbashkët mes këtyre dy entiteteve, që njihet si Komisioni i Përbashkët për Çështje Ekonomike dhe Fiskale.

Gjykata Supreme e Drejtësisë e Katalonisë është trupi suprem juridik, kompetent në fushat e të drejtës civile, penale, administrative dhe juridike dhe mbrojtjen e drejtat e njohura me Statutin e Katalonisë. Kjo gjykatë ka autoritet ekskluziv për të interpretuar ligjin në Kataloni. Presidenti i kësaj gjykate është përfaqësues i pushtetit juridik në Kataloni, nominohet nga Mbreti, në bazë të propozimit të Këshillit të Përgjithshëm të Pushtetit Gjyqësor dhe me pjesëmarrje të Këshillit të Drejtësisë të Katalonisë. Po ashtu, Gjykata Supreme e Drejtësisë e Katalonisë ka Prokurorin Publik, që është prokuror suprem dhe përfaqëson Shërbimin e Prokurorisë Publike të Katalonisë.<sup>82</sup>

Në çështjet e **sigurisë publike**, në përputhje me legjislacionin shtetëror, Katalonia është përgjegjëse për planifikim dhe rregullim të sistemit të sigurisë publike, organizim të **policisë lokale**, krijim dhe organizim të **Forcës Policore** mbi të cilën ka komandë supreme dhe koordinon aktivitetet e policisë lokale. Po ashtu, Forca Policore ka përgjegjësi edhe për kontroll të trafikut dhe ushtron të gjitha funksionet në siguri e rend publik dhe hetim të krimit të organizuar e terrorizmit. Duhet thënë edhe se Katalonia në bashkëpunim me shtetin koordinon politikat e sigurisë.<sup>83</sup>

80 Kaptina V, neni 162, Kujdesi Shëndetësor, Shëndeti Publik, Rregullimi Farmaceutik dhe Produktet Farmaceutike.

81 Kaptina VI Mjetet Financiare të Generalitat, Kapitulli I Financat e Generalitat.

82 Kaptina III Pushteti Juridik në Kataloni, Kapitulli I Gjykata Supreme e Drejtësisë dhe Prokurori Publik në Kataloni, neni 95 Gjykata Supreme e Drejtësisë, pika 1, 2, 3, 4, 5 e 6 dhe neni 96 Prokurori Publik i Katalonisë.

83 Kaptina V, neni 164 Siguria Publike.



Generalitat dhe Shteti i ofrojnë ndihmë njëri-tjetrit kur është e nevojshme në mënyrë që të ushtrojnë kompetencat e tyre. Generalitat merr pjesë në institucionet vendim-marrëse të Spanjës sa i takon kompetencave që ka dhe mund të bëjnë marrëveshje bashkëpunimi. Pjesëmarrja në institucionet vendim-marrëse të shtetit përfshin pjesëmarrjen në Senatin e Spanjës të senatorëve të zgjedhur në territorin e Katalonisë dhe atyre që përfaqësojnë Generalitat, pjesëmarrjen në Gjykatën Kushtetuese, pjesëmarrjen e përfaqësuesve në trupat ekonomike dhe shoqërorë. Po ashtu, parashihet krijimi i komisioneve bilaterale Generalitat-Shtet. Generalitat mund të vendosë lidhje bashkëpunimi edhe me komunitetet tjera autonome.<sup>84</sup> Për më shumë, Generalitat ka të drejtë të vë marrëdhënie edhe me Bashkimin Europian, duke marrë pjesë në marrëveshjet e BE-së, por edhe në institucionet dhe trupat e BE-së, e kështu me radhë. Generalitat ka kompetenca për implementuar ligjet e Bashkimit Europian nëse kanë të bëjnë me kompetencat e Katalonisë.

Për të promovuar interesat e Katalonisë, *Generalitat* ka të drejtë të themelojë **zyra jashtë** vendit dhe të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi në fushat që janë kompetencë e saj. Sa i takon **marrëveshjeve ndërkombëtare** Spanja duhet ta informojë Kataloninë paraprakisht nëse ato marrëveshje kanë efekt të drejtpërdrejtë në kompetencat e Katalonisë. Po ashtu, Katalonia ka të drejtë për **bashkëpunim tej-kufitar dhe ndër-regjional**.<sup>85</sup>

---

84 Kaptina V Marrëdhëniet Institucionale të Generalitat, Kapitulli I Marrëdhëniet e Generalitat me Shtetin dhe Komunitetet tjera Autonome, neni 174, pika 1, 2 dhe 3.

85 Neni 197 Bashkëpunimi Tej-Kufitar dhe Ndër-regjional.

## 6. PËRFUNDIME

Në Kosovë **gjuhë** zyrtare janë gjuha shqipe dhe ajo serbe, kurse gjuha turke, boshnjake dhe rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komunal ose janë në përdorim zyrtar në përputhje me ligjin. Në Maqedoni, zyrtare në nivel shteti është vetëm gjuha maqedone, kurse çdo gjuhë tjetër e një komuniteti që përbën të paktën 20% të popullatës së një komune është zyrtare në atë komunë. Edhe në Serbi, zyrtare në nivel shteti është vetëm gjuha serbe, kurse në territorin e Vojvodinës, përveç gjuhës serbe, janë zyrtare edhe gjuha hungareze, sllovaqe, rumune, kroate dhe rusine. Në anën tjetër, në rajonin e Tiroli të Jugut në Itali njihen si njëloj zyrtare gjuha gjermane dhe italiane, kjo e fundit duke qenë gjuhë zyrtare në gjithë territorin e Italisë. Njëjtë, në kuadër të Katalonisë, njihen në mënyrë të barabartë si zyrtare gjuha katalone dhe spanjolle, kjo e fundit duke qenë zyrtare në gjithë shtetin e Spanjës.

Pra, gjuha shqipe nuk është zyrtare në tërë territorin e Maqedonisë, gjuha hungareze nuk është zyrtare në tërë territorin e Serbisë, gjuha gjermane nuk është zyrtare në tërë territorin e Italisë dhe gjuha katalone nuk është zyrtare në tërë territorin e Spanjës, por gjuha serbe, krahas gjuhës shqipe, është zyrtare në gjithë territorin e Kosovës. Kjo edhe mund të jetë arsyeja pse Platforma Politike e Serbisë për Negociata me Kosovën nuk i trajton fare të drejtat e serbëve në Kosovë në fushë të gjuhës.

Në fushën e **mediave**, më specifikisht të televizioneve, serbët e Kosovës kanë të drejtën për një kanal televiziv publik të pavarur, të licencuar në gjuhën serbe në mbarë territorin e Kosovës, ndërsa shqiptarët në Maqedoni kanë të drejtë për program në gjuhën shqipe në kuadër të kanalit të dytë publik të RTV të Maqedonisë (MTV2), i cili transmeton program për minoritetet kombëtare, jo vetëm në shqip, por edhe në turqisht, serbisht, romanisht, vllahisht e boshnjakisht. Vojvodina ndërkaq e siguron punën e mediave relevante për krahinën në gjuhët e komuniteteve nacionale që përbëjnë minoritetet numerik në popullatën e tërësishme të krahinës, kurse RTV publik i Vojvodinës transmeton program në 10 gjuhë. Në anën tjetër, krahinat e rajonit të Tiroli të Jugut në Itali nuk kanë të drejtë të themelojnë stacione radio-televizive, por është televizioni publik italian RAI ai që ka një qendër transmetimi në Bolzano, e cila prodhon program ditor tregjuhësor. Ndërkaq në Spanjë, Katalonia, e cila promovon pluralizmin e vet gjuhësor e kulturor në media, ka transmetuesin televiziv publik, të njohur si TVC, i cili transmeton program veç në gjuhën

katalone dhe veç brenda territorit të Katalonisë.

Pra, në fushën e mediave, shqiptarët dhe komunitetet e tjera në Maqedoni, si dhe hungarezët dhe komunitetet tjera në Vojvodinë, kanë të drejtë për kanal publik televiziv të përbashkët me komunitetet e tjera pakicë. Tirol i Jugut ka një qendër të televizionit publik italian RAI që transmeton program tregjuhësor e Katalonia ka televizion publik që transmeton program vetëm në gjuhën katalone dhe vetëm në territorin e Katalonisë. Sërbët në Kosovë ndërkaq kanë të drejtë ta krijojnë dhe ta drejtojnë një kanal televiziv publik të pavarur, të licencuar në gjuhën serbe, që transmetohet në mbarë territorin e Kosovës. Ndryshe nga të drejtat e serbëve në Kosovë në fushë gjuhe që nuk përmenden fare në Platformën Politike të Sërbisë për Negociata me Kosovën, të drejtat e tyre në fushën e mediave përmenden, ndonëse në një fjali të vetme dhe krejt përciptazi.

Sa i takon **arsimit**, serbët në Kosovë kanë të drejtën e arsimimit publik në gjuhën e tyre në krejt nivelet akademike, duke u bazuar në planprogramet dhe tekstet mësimore e Sërbisë, si dhe të themelojnë universitetin që do të njihet si Universiteti i Mitrovicës Veriore. Edhe në Maqedoni shkollimi fillor dhe ai i mesëm zhvillohen në gjuhën amtare të nxënësve, por përdoren planprograme akademike uniforme në tërë Maqedoninë, kurse në nivelin universitar, shteti duhet të sigurojë financim për universitetin, nëse në atë universitet studiohet në gjuhën që flitet nga të paktën 20% e popullatës së Maqedonisë. Edhe Vojvodina garanton ushtrimin e të drejtës për edukim në gjuhë amtare për komunitetet nacionale në të gjitha nivelet akademike, por në bazë të planprogrameve të Sërbisë. Duhet potencuar se edukimi në Sërbi në të gjitha nivelet zhvillohet në gjuhën serbe dhe, në rrethana të caktuara, mund të zhvillohet edhe në gjuhë të minoriteteve kombëtare. E njëjta vlen edhe për Vojvodinën. Në Tirol të Jugut dhe në Kataloni, mësimi në shkollat fillore dhe të mesme zhvillohet në gjuhët italiane e gjermane, përkatësisht katalone. Sa i takon nivelin universitar, për themelimin e universitetit në Tirolin e Jugut, Italia duhet të marrë pëlqimin e këtij rajoni, ku universiteti është shumëgjuhësh. Katalonia ka kompetenca për të krijuar universitete publike dhe për t'i autorizuar ato privatet, si dhe për t'i aprovuar statutet e universiteteve.

Siç shihet, serbët në Kosovë, shqiptarët në Maqedoni, hungarezët në Vojvodinë, gjermanishtfolësit në Tirolin e Jugut dhe katalonët në Spanjë kanë të drejtë për arsimim publik në gjuhët e tyre në krejt nivelet, por vetëm serbët

në Kosovë kanë të drejtë që arsimin ta pranojnë në bazë të planprogrameve të një shteti tjetër, pra të shtetit të Serbisë. Sa i takon nivelit universitar, serbët në Kosovë kanë të drejta pothuajse të ngjashme me ato të Katalonisë, kurse qëndrojnë më mirë në krahasim me Tirolin e Jugut, e sidomos në krahasim me hungarezët në Vojvodinë të Serbisë dhe me shqiptarët në Maqedoni. Edhe në këtë pikë, krejt çka parasheh Platforma Politike e Serbisë për Negociata me Kosovën është kompetenca në arsim fillor, të mesëm dhe të lartë.

Në **shëndetësi**, komuna të caktuara me shumicë serbe në Kosovë kanë kompetenca të zgjeruara në ofrimin e kujdesit shëndetësor sekondar, të cilat duhet të specifikohen. Në Maqedoni parashihet forcimi i pushtetit të zyrtarëve lokalë dhe zgjerimi përmbajtësor i kompetencave të tyre në shërbimin shëndetësor, por në përputhje me Kartën Europiane për Vetëqeverisje Lokale. Vojvodina, në anën tjetër, ka të drejtë që të themelojë institucione për mbrojtje shëndetësore, jo vetëm sekondare, por edhe terciare. Edhe Tirolin e Jugut ka kompetenca legjislative në rregullimin e punës së agjencive për shëndetësi dhe spitale. Katalonia ndërkaq ka kompetenca ekskluzive për organizimin, funksionimin, vlerësimin, inspektimin dhe kontrollin e qendrave dhe të shërbimeve shëndetësore, kurse kompetenca të ndara në: klasifikimin, planifikimin, përcaktimin dhe ekzekutimin e shërbimeve shëndetësore publike, sociale dhe mentale në të gjitha nivelet dhe për të gjithë qytetarët. Në kompetenca të ndara hyjnë edhe: bashkërendimi i veprimtarive të sektorit shëndetësor publik me atë privat si dhe akreditimi e evaluimi i qendrave të kujdesit shëndetësor, por edhe pjesëmarrja në planifikimin dhe bashkërendimin shtetëror në fushën e kujdesit shëndetësor.

Në krahasim me shqiptarët në Maqedoni që kanë të drejta në shëndetësi sa u takon komunave, duke marrë për bazë edhe Kartën Europiane për Vetëqeverisje Lokale, serbët në Kosovë, përveçse në nivel parësor, kanë kompetenca të zgjeruara edhe në nivel dytësor, të cilat duhen specifikuar. Vojvodina, Tirolin e Jugut dhe Katalonia kanë kompetenca pothuajse në të gjitha nivelet. Pikërisht këtë, pra kompetencat në të gjitha nivelet e shëndetësisë, e synon për serbët në Kosovë Platforma Politike e Serbisë për Negociata me Kosovën.

Lidhur me **financat**, komunat me shumicë serbe në Kosovë përveçse mbledhin tatime lokale, pagesa, tarifa - por jo tarifa doganore, tatime në të ardhura, tatime mbi vlerën e shtuar, detyrime të akcizës, tatime në kapital – si dhe tatime në pronën e paluajtshme që gjendet në territorin e komunës, ato

financohen edhe nga shpërndarja e granteve të përgjithshme, të cilat duhet të marrin parasysh, *inter alia*, edhe numrin e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë në komunë. Për më shumë, këto komuna kanë të drejtë të bashkëpunojnë edhe me komunat dhe institucionet e Sërbisë për ndihmë financiare, por në pajtueshmëri me legjislacionin qendror. Në anën tjetër, për komunat me shumicë shqiptare në Maqedoni nuk ekzistojnë të drejta të tilla, por vetëm parashihet forcimi dhe zgjerimi përmbajtësor i kompetencave të njëjësive lokale të vetëqeverisjes në fushën e financave lokale, por në përputhje me Kartën Europiane për Vetëqeverisje Lokale.

Ndryshe qëndron situata me Vojvodinën, e cila për financimin e aktiviteteve në kuadër të kompetencave që ka, merr nga buxheti i Vojvodinës të paktën 7% të buxhetit të Sërbisë dhe i siguron të ardhurat e veta edhe nëpërmjet: mbledhjes së taksave; të ardhurave vjetore nga prona, kur është titullare e saj; pjesëmarrjes në të ardhura të ndërmarrjeve publike dhe institucioneve; kredive publike, komerciale; bartjes së resurseve buxhetore, të donacioneve e granteve dhe të burimeve tjera.

Ndërkaq, sa u takon modeleve europiane të autonomive, Tiroli i Jugut financohet nga të ardhurat prej tatimit në pronë që gjendet në territorin e rajonit, por i takojnë edhe këto kuota: 9/10 nga tatimet mbi trashëgiminë dhe donacionet; 2/10 e tatimit të përgjithshëm mbi të ardhurat në shkallë rajonale; dhe 90% e të ardhurave nga lotaria; krahinat financohen nga të ardhurat prej tatimit mbi shpenzimin e gazit dhe të energjisë që mblidhen në krahina. Po ashtu, 90% e tatimit mbi të ardhurat, të grumbulluar në territoret e krahinave, u takon krahinave. Ndërsa, Katalonia financohet nga tatimet që mblidhen në territorin e saj, si: tatimi në të ardhura, tatimet prej të cilave Spanja heq dorë totalisht dhe tatimet prej të cilave heq dorë pjesërisht, mandej prej transfereve dhe alokimeve nga Spanja, prej pagesave të shërbimeve publike, si dhe nga kreditë, gjobat e nga donacionet prej BE-së, e kështu me radhë.

Në këtë pikë, pra të financave, sërëbët në Kosovë gëzojnë shumë më shumë të drejta sesa shqiptarët në Maqedoni, e në disa segmente edhe më shumë se Vojvodina. Por, siç u potencua edhe më sipër, në shumë aspekte të drejtat e Tirolit të Jugut dhe të Katalonisë në financa janë shumë më të avancuara. Në fund të fundit, ajo që po e kërkon Platforma Politike e Sërbisë për Negociata me Kosovën për sërëbët në Kosovë sa i takon fushës së financave, pra bashkëpunimin e drejtpërdrejtë me autoritetet e Sërbisë, përfshi të drejtën

e financimit shtesë nga mjetet e ndara nga buxheti i Sërbisë, tashmë është e garantuar me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.

Sërbët e Kosovës dhe shqiptarët e Maqedonisë kanë të drejtë pak a shumë të njëjta në **polici**, të cilat konsistojnë në përfaqësim të barabartë proporcional për punësim në sektorin e policisë në zonat e banuara me sërbë në Kosovë, përkatësisht shqiptarë në Maqedoni, e edhe në zgjedhjen e komandantëve të stacioneve policore në komuna, por që në nivel qendror ruhet zinxhiri i unifikuar i komandës së policisë. Në këtë fushë, Vojvodina nuk ka të drejta të specifikuar që e bëjnë të dallohet nga pjesët e tjera të territorit të Sërbisë. Ndërsa forcat policore në Tirolin e Jugut kanë kompetenca për kryerjen e aktiviteteve të patrullimit të trafikut rrugor, menaxhimit të tiketave dhe të çështjeve legale, në çështjet e sigurisë publike, Katalonia është përgjegjëse për planifikimin dhe rregullimin e sistemit të sigurisë publike, organizimin e policisë lokale, krijimin dhe organizimin e Forcës Policore mbi të cilën ka komandë supreme dhe koordinimin e aktiviteteve të policisë lokale. Po ashtu, Forca Policore ka përgjegjësi edhe për kontroll të trafikut dhe ushtron të gjitha funksionet për siguri e rend publik dhe hetim të krimit të organizuar e të terrorizmit. Me Platformën Politike të Sërbisë për Negociata me Kosovën kërkohet të themelohet policia autonome e sërbeve në Kosovë sipas modelit të Katalonisë dhe me përgjegjësi të ngjashme, e që në kuptimin formal do të ishte pjesë e Forcave Policore të Kosovës, edhe pse do të funksiononte nën autoritetin e Këshillit Ekzekutiv të Bashkësisë së Komunave Sërbe të Kosovës dhe Metohisë.

Ndryshe nga Maqedonia për shqiptarët e nga Vojvodina për hungarezët e të tjerët, por edhe nga Italia për Tirolin e Jugut dhe Spanja për Kataloninë, në fushën e **religjionit** Kosova u siguron mbrojtje të veçantë tërësisë së objekteve dhe monumenteve kulturore e fetare të komunitetit sërb. Kosova e njej Kishën Ortodokse Sërbe (KOS) në Kosovë si pjesë integrale e KOS-it me seli në Beograd dhe i ofron siguri shtesë dhe masa të tjera mbrojtëse. Autoritetet e Kosovës kanë qasje në këtë pronë vetëm me pëlqimin nga Kisha ose në rastet kur lëshohet urdhër gjyqësor lidhur me aktivitetet joligjore. KOS në Kosovë mund të pranojë donacione nga çdo institucion brenda ose jashtë Kosovës, por në mënyrë të hapur. Kosova i ofron KOS-it në Kosovë privilegje doganore dhe tatimore. Në bazë të Platformës Politike për Negociata me Kosovën, Sërbia kërkon të vendoset një marrëdhënie speciale kontraktuale

mes kishës ortodokse sërbe dhe institucioneve të Kosovës dhe të jepet një garanci e vlefshme ndërkombëtarisht lidhur me premtimet që i bëhen Kishës Ortodokse Sërbe, pronës kishtare dhe aktivitetit të Kishës Ortodokse Sërbe në territorin e Kosovës.

Në fushën e **gjqësisë**, sërbëve në Kosovë u garantohet Së paku 15% e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, jo më pak se 3, vijnë nga komunitetet jo shumicë dhe së paku 15% e gjyqtarëve të secilës gjykatë të qarkut, jo më pak se 2, vijnë nga komunitetet jo shumicë. Komuna me shumicë prej komuniteteve jo shumicë të Kosovës, mund ta parqet kërkesën para Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për themelim të gjykatës themelore ose që gjykata nga komuna tjetër të ketë juridiksion mbi komunën që nuk ka gjykatë themelore. Nëse KGJK refuzon këtë kërkesë, atëherë themelohen zyre ndërlidhëse, ose gjykata themelore mbanë seancat në territorin e komunës që nuk ka gjykatë. KGJK i jep përparësi pjesëtarëve të komuniteteve të nën-përfaqësuara deri atëherë kur përqindja e gjyqtarëve dhe prokurorëve pjesëtarë të komuniteteve serb në Kosovë të jetë nën 8% dhe/ose atyre të komuniteteve jo shumicë të jetë nën 15%. KGJK do të përbëhet nga 13 anëtarë, ku dy prej tyre do t'i zgjedhin deputetët që mbajnë ulëset e rezervuara për komunitetin serb të Kosovës, 2 do t'i zgjedhin deputetët që mbajnë ulëset e rezervuara për përfaqësuesit e komuniteteve tjera, dhe 2 do t'i zgjedhin deputetët që mbajnë ulëset e fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të ulëseve.

Në këtë sferë, për shqiptarët në Maqedoni parashihet që pa shumicën e votave të numrit total të përfaqësuesve që pretendojnë se u takojnë komuniteteve joshumicë (2/3) nuk mund të zgjedhen një e treta e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe tre prej anëtarëve të Këshillit Gjyqësor. Vojvodina, ndërkaq, ka të drejtë të propozojë që gjykatat, të cilat funksionojnë në territorin e krahinës, të krijojnë një rrjet. Në anën tjetër, ndërsa në Tirolin e Jugut ekziston gjykatë rajonale, ama gjykatë administrative, ku të dy bashkësitë kryesore gjuhësore janë të përfaqësuara në mënyrë të barabartë, në Kataloni Gjykata Supreme e Drejtësisë e Katalonisë është trupi suprem juridik, kompetent në fushat e të drejtës civile, penale, administrative dhe juridike dhe mbron të drejtat e njohura me Statutin e Katalonisë. Kjo gjykatë ka autoritet ekskluziv për të interpretuar ligjin në Kataloni. Presidenti i kësaj gjykate është përfaqësues i pushtetit juridik në Kataloni, nominohet nga Mbreti, në bazë të propozimit të Këshillit të Përgjithshëm të Pushtetit Gjyqësor dhe me pjesëmarrje të

Këshillit të Drejtësisë të Katalonisë. Po ashtu, Gjykata Supreme e Drejtësisë e Katalonisë ka Prokurorin Publik, që është prokuror suprem.

Në këtë pikë, Platforma Politike për Negociata me Kosovën parasheh që qytetarët e Bashkësisë së Komunave Sërbe, përmes përfaqësuesve të tyre mund të ndikojnë në zgjedhjen dhe përbërjen e gjykatave, të cilat në rajonin e Bashkësisë së Komunave Sërbe do të kenë autoritetin të vendosin mbi të gjitha çështjet gjyqësore që ndërlidhen me marrëdhëniet bazike personale, të drejtat dhe detyrat e qytetarëve, të shpallin dënime dhe masa të tjera kundër kryesve të veprave kriminale dhe veprave të tjera të dënueshme të përcaktuara me ligj; të vendosin rreth ligjshmërisë së akteve individuale të organeve dhe të organizatave që ushtrojnë autoritet publik; të vendosin për rastet e ndërlidhura me çështjet pronësore ose çështjet e ligjit të punës dhe të vendosin rreth çështjeve të tjera në pajtim me ligjet në fuqi.

Sa u takon **institucioneve politike**, shqiptarët në Maqedoni nuk të drejta të krijojnë çfarëdo qoftë institucioni politik që do t'i përfaqësonte të drejtat e tyre, kurse sërëbët në Kosovë, saktësisht komunat me shumicë sërbe, kanë të drejtë të krijojnë **partneritet** mes vete për zbatimin e përgjegjësive komunale dhe të kompetencave të zgjeruara, *inter alia*, përmes: themelimit të një organi vendimmarrës me përfaqësues të komunave pjesëmarrëse. Partneriteti ka të drejtë për marrëdhënie të drejtpërdrejta me institucionet në Sërbi vetëm deri në masën e nevojshme për zbatimin e aktiviteteve të partneritetit. Vendimet dhe aktivitetet e partneritetit duhet t'u nënshtrohen kërkesave për raportim te autoriteti kompetent qendror, si dhe shqyrtimit administrativ për pajtueshmëri me legjislacionin. Komunat e angazhuara në partneritet duhet t'i publikojnë informatat për aktivitetet dhe buxhetin e partneritetit. Ndërkaq, Vojvodina ka institucione legjislative e ekzekutive: Kuvendin që mund të ndërmarrë aktivitete në kuadër të kompetencave që ka krahina, si dhe Qeverinë, e cila është ekzekutuese e vendimeve të Kuvendit. Edhe Tiroli i Jugut ka institucionet legjislative e ekzekutive për të ushtruar kompetencat e veta: Këshillin Rajonal me kompetenca legjislative; Këshillin Ekzekutiv Rajonal, trup ekzekutiv për zbatimin e ligjeve në rajon; si dhe Kryetarin e Këshillit Ekzekutiv, i cili e përfaqëson Rajonin. Po ashtu, edhe Katalonia ka institucionet e veta si: Parlamentin, Presidencën dhe Qeverinë. Njësoj, Platforma Politike e Sërbisë për Negociata me Kosovën synon që Bashkësia e Komunave Sërbe të Kosovës dhe Metohisë të ketë institucione legjislative dhe ekzekutive, përkatësisht



Asamble dhe Këshill Ekzekutiv, që do të ngarkohen me zbatimin e detyrave nga përkufizimi i përgjegjësive të tyre.

Derisa në Sërbi, por edhe në Itali dhe Spanjë nuk parashihen **procedura speciale parlamentare**, në Maqedoni kërkohet shumica e votave të numrit total të përfaqësuesve që pretendojnë se u takojnë komuniteteve joshumicë (2/3), për të zgjedhë: një të tretën e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese; tre prej anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, dhe Ombudspersonin. Kjo shumicë nevojitet edhe për ndryshimin e disa amendamenteve kushtetuese dhe të vetëqeverisjes lokale në: kulturë, përdorim të gjuhës, edukim, dokumentacion personal, përdorim të simboleve, ligje për financa lokale, për zgjedhje lokale, për qytetin e Shkupit dhe për kufijtë e komunave. Ndërsa, në Kosovë, pa votat e shumicës së deputetëve të komuniteteve joshumicë, nuk mund të miratohen, ndryshohen a shfuqizohen: ligjet që ndryshojnë kufijtë komunalë, themelojnë ose shuajnë komunat, përcaktojnë shtrirjen e pushteteve të komunave dhe pjesëmarrjen e tyre në marrëdhëniet ndërkomunale e tejkuftare; ligjet që implementojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, përveç atyre të përcaktuara me kushtetutë; ligjet për përdorimin e gjuhëve; për zgjedhjet lokale; për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore; për lirinë fetare ose për marrëveshjet me komunitetet fetare; për arsimin; për përdorimin e simboleve (përfshirë simbolet e komunitetit) dhe festat publike. Për çdo ndryshim të Kushtetutës kërkohet miratimi i dy të tretave të deputetëve që mbajnë vende të rezervuara për komunitetet jo shumicë në Kosovë. Kjo i jep komunitetit sërb në Kosovë karakter konstituiv.

Po ashtu, në Sërbi, por edhe në Itali dhe Spanjë, nuk parashihen mekanizma për përfaqësim special. Në Maqedoni parashihet pjesëmarrja e një partie shqiptare në Qeveri, por ky parim është në nivel të *përkushtimit*, e jo *detyrimit kushtetues*. Në anën tjetër në Kosovë janë 20 ulëse të rezervuara për deputetë që përfaqësojnë komunitetet joshumicë në Kosovë: 10 për komunitetin sërb dhe 10 për komunitetet tjera, kurse çdo ulëse e fituar përmes zgjedhjeve do të jetë ulëse shtesë. Deputetët e komunitetit sërb do të kenë: së paku një përfaqësues në Kryesinë e Kuvendit; së paku një zëvendëskryesues në secilin komision parlamentar do të jetë nga komuniteti tjetër prej atij që i përket kryesuesi; së paku një ministër dhe dy zëvendësministra do të jenë nga komuniteti sërb. Në komunat në të cilat së paku 10% e banorëve i përkasin komuniteteve joshumicë, posti i zëvendëskryetarit për komunitete rezervohet

për një përfaqësues të komuniteteve, kurse posti tjetër i zëvendëskryetarit do të mbahet nga kandidati që i përket popullatës joshumicë që ka marrë shumicën e votave.

Duhet thënë edhe se për dallim prej të gjitha shteteve që janë marrë si bazë e këtij publikimi, Kosova është i vetmi rast që është shtet i të gjitha komuniteteve etnike, ku komunitetet jo shumicë janë të barabarta me komunitetin shumicë dhe, për më shumë, nuk cilësohen si minoritete, sikur që ngjanë me shtetet tjera.

Për fund, ky raport, veç tjerash, ka përmbledhë të gjitha të drejtat që Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës për sërëbët në Kosovë, të cilat, në shumë fusha janë më të avancuara se të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni dhe të hungarezëve e komuniteteve të tjera që jetojnë në Krahinën Autonome të Vojvodinës në Sërbi. Për më shumë, në disa fusha, të drejtat e sërëbëve sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës janë edhe më të avancuara se të drejtat e parapara për Tirolin e Jugut në Itali dhe në Kataloni të Spanjës.

Sidoqoftë, në rast se sërëbët në Kosovë duhet t'i zgjerojnë të drejtat në fushat si, ta zëmë, shëndetësia, policia, gjyqësia dhe krijimi i institucioneve politike legjislativë e ekzekutive, kryesisht në përputhje me modelin e Katalonisë, ashtu siç parasheh Platforma Politike e Sërëbisë për Negociatë me Kosovën, a duhet që edhe të drejtat e zgjeruara të sërëbëve në Kosovë, siç i parasheh Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, në gjuhë, media, arsim dhe religjion, të ngushtohen po sipas modelit të Katalonisë? Po ashtu, të drejtat e zgjeruara të sërëbëve në Kosovë në gjuhë, media, arsim e religjion dhe zgjerimi i mëtutjeshëm i këtyre të drejtave në shëndetësi, polici, gjyqësi dhe krijimi i institucioneve politike legjislativë e ekzekutive, a mund të shërëbejë si model për riaranzhim të të drejtave të komuniteteve joshumicë në shtetet fqinje, si Maqedonia dhe Sërëbia?

**Tabelë krahasimore e disa modeve të akomodimit të të  
rejtave të minoriteteve**

## Gjuhë

|  | Kosova  | Maqedonia  | Serbia<br>(Vojvodina)   | Italia  | Spanja   | PPS           |
|--|---|--|---|---|--|---------------|
|  | <p>Gjuhë zyrtare janë gjuha shqipe dhe gjuha serbe, kurse gjuha turke, boshnjake dhe rome kanë statusin e gjuhës zyrtare në nivel komunal ose janë në përdorim zyrtar në përputhje me ligjin.</p> | <p>Gjuhë zyrtare është gjuha maqedone, kurse çdo gjuhë tjetër që flitet të paktën nga 20% e popullatës është po ashtu gjuhë zyrtare, por në njësitë lokale vetëqeverisëse, ku një komunitet përbën të paktën 20% të popullatës së asaj njësie.</p> | <p>Gjuhë zyrtare është gjuha serbe, kurse në territorin e Vojvodinës, përveç gjuhës serbe, gjuhë zyrtare janë edhe gjuha: hungareze, sllovake, rumune, kroate dhe rusine.</p> | <p>Në rajonin e Tirolit të Jugut gjuhë zyrtare njihen në mënyrë të barabartë gjuha gjermane dhe italiane, kurse kjo e fundit është gjuhë zyrtare në krejt territorin e Italisë.</p> | <p>Në kuadër të Katalonisë gjuhë zyrtare njihen në mënyrë të barabartë gjuha katalone dhe spanjolle, kurse kjo e fundit është gjuhë zyrtare në krejt territorin e Spanjës.</p> | <p>Nuk ka</p> |

## Media

| Kosova   | Maqedonia   | Serbia (Vojvodina)  | Italia   | Spanja  | PPS                                   |
|--|---|---|--|---|---------------------------------------|
| <p>Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë, si individë ose si komunitet, që të kenë qasje të garantuar dhe përfaqësimit të posaçëm në mediat transmetuese publike si dhe t'i kenë programet në gjuhën e tyre, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare. Ata kanë të drejtë për t'i krijuar dhe përdorë mediat e tyre. Komunitetit sërë në Kosovë i mundësohet qasje në një kanal televiziv të pavarur, të licencuar në gjuhën sërbe në mbarë Kosovën. RTK transmeton program në: shqip, serbisht, turqisht, boshnjakisht dhe në gjuhën rome.</p> | <p>Palët e ftojnë bashkësinë ndërkombëtare, të rrisë mbështetjen për projektet në fushën e mediave për të forcuar radion, televizionin dhe median e shtypur, përfshi median në gjuhën shqipe dhe atë multietnike, por edhe të shtojë programet trajnuese profesionale për media për anëtarët e komuniteteve jo-shumicë në Maqedoni. Kanali 2 i RTV Maqedonisë transmeton program për minoritetet kombëtare: shqip, turqisht, serbisht, romanisht, vllahisht dhe boshnjakisht.</p> | <p>Vojvodina ka të drejtë që të definojë interesin publik të qytetarëve të krahinës në fushën e informimit publik dhe radio-difuzionit dhe më specifikisht të rregullojë kushtet dhe mënyrën e performimit të aktiviteteve të Shërbimit Radio Difuziv Krahinor. Po ashtu, Vojvodina duhet të sigurojë punën e mediave relevante për krahinën në gjuhët e komuniteteve nacionale që përbëjnë minoritet numerik në popullatën e tërësishtme të krahinës. RTV i Vojvodinës transmeton program në 10 gjuhë.</p> | <p>Krahinat nuk kanë të drejtë të themelojnë stacione radio televizive. Televizioni publik italian RAI ka një qendër transmetimi në Bolzano që prodhon program ditor treguhësor.</p> | <p>Garantohet e drejta për informim nga mediat, të cilat duhet të respektojnë pluralizmin politik, shoqëror, kulturor dhe fetar. Katalonia ka kompetenca ekskluzive sa i takon organizimit të shërbimeve të transmetuesit publik, kurse kompetenca të ndara sa i takon rregullimit dhe kontrollit të shërbimeve të transmetimit. Katalonia duhet të promovojë pluralizmin gjuhësor dhe kulturor të Katalonisë në media. Në Kataloni ekziston transmetuesi televiziv publik, i njohur si TVC që transmeton program vetëm në gjuhën katalone.</p> | <p>Shërbime të informimit publik.</p> |

## Edukim

| Kosova   | Maqedonia  | Serbia<br>(Vojvodina)   | Italia   | Spanja  | PPS   |
|--|--|---|--|---|---|
| <p>Pjesëtarët serbë kanë të drejtë të pranojnë arsimim publik në gjuhën e tyre në krejt nivelet; kurse shkollat në gjuhën serbe mund të zbatojnë planprograme të Serbisë.</p> <p>Parashihet themelimi i Universitetit të Mitrovicës Veriore, i cili do të ndërveprojë me autoritetet publike, në pajtim me legjislacionin qendror.</p> | <p>Shkollimi fillor dhe i mesëm zhvillohen në gjuhën amtare të nxënësve; programet akademike do të përdoren uniforme në tërë Maqedoninë.</p> <p>Në nivelin universitar, në bazë të marrëveshjeve specifike, shteti duhet të sigurojë financim për edukimin në gjuhën që flitet nga të paktën 20% e popullatës së Maqedonisë.</p> | <p>Garantohet ushtrimi i të drejtës për edukim në gjuhë amtare për personat e komuniteteve nacionale në të gjitha nivelet e edukimit. Mirëpo, edukimi në Serbi në të gjitha nivelet zhvillohet në gjuhën serbe dhe, në rrethana të caktuara, mund të zhvillohet në gjuhë të minoriteteve kombëtare. E njëjta vlen për Vojvodinën.</p> | <p>Në krahinën Bolcano në arsimin fillor e të mesëm, mësimi zhvillohet në gjuhën italiane dhe gjermane. Për themelimin e universitetit në krahinë, Italia duhet të marrë përgjimin e rajonit dhe të krahinës. Universiteti në Bolcano është multilingual (germanisht, italisht dhe anglisht)</p> | <p>Në edukim jo-universitar Katalonia ka kompetenca për: vendosje të programeve mësimore; kurse në atë universitar për krijimin e universiteteve publike dhe autorizimin e atyre private, si dhe aprovimin e statuteve të universiteteve.</p> | <p>Arsimim fillor, të mesëm dhe të lartë.</p> |

## Shëndetësi

|  | Kosova   | Maqedonia   | Serbia<br>(Vojvodina)  | Italia  | Spanja  | PPS                                      |
|--|--|---|--|---|---|--|
|  | <p>Komuna të caktuara me shumicë serbe kanë kompetenca të zgjeruara në ofrim të kujdesit shëndetësor sekondar.</p> | <p>Parashihet forcimi i pushtetit të zyrtarëve lokalë dhe zgjerimi përmbajtësor i kompetencave të tyre, në përputhje me Kartën Europiane për Vetëqeverisje Lokale, në shërbimin shëndetësor</p> | <p>Vojvodina ka të drejtë që të themelojë institucione për mbrojtje shëndetësore sekondare dhe terciare.</p> | <p>Rajoni Tiroli i Jugut ka kompetenca legjislative në rregullimin e punës së agjencive të ngarkuara për shëndetësi dhe spitale; dhe në nxjerrjen e ligje për ndihmat shëndetësore spitalore.</p> | <p>Katalonia ka kompetenca ekskluzive në organizim, funksionim, vlerësim, inspektim dhe kontroll të qendrave dhe shërbimeve shëndetësore; kurse, kompetenca të ndara në: klasifikim, planifikim, përcaktim dhe ekzekutim të shërbimeve shëndetësore publike, sociale dhe mentale në të gjitha nivelet dhe për të gjithë qytetarët. Në kompetenca të ndara hyjnë edhe: koordinimi i aktiviteteve të sektorit shëndetësor publik me atë privat dhe akreditimi e evaluimi i qendrave të kujdesit shëndetësor, por edhe pjesëmarrja në planifikimin dhe koordinimin shtetëror në fushën e kujdesit shëndetësor.</p> | <p>Të gjitha nivelet e shëndetësisë.</p> |

## Financa

|  | Kosova  | Maqedonia  | Serbia (Vojvodina)  | Italia  | Spanja   | PPS |
|--|---|--|---|---|--|-----|
|  | <p>Komunat mbledhin tatime lokale, pagesa dhe tarifa, por jo tarifa doganore, tatime në të ardhura, tatime mbi vlerën e shtuar, detyrime të akcizës, tatime në kapital, përveç tatimeve në pronën e paluajtshme që gjendet në territorin e komunës. Shpërndarja e granteve të përgjithshme duhet me marrë parasysh, inter alia, edhe numrin e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë në komunë. Komunat me shumicë sërbe kanë të drejtë të bashkëpunojnë me komunat dhe institucionet e Sërbisë për ndihmë financiare në pajtueshmëri me legjislacionin qendror.</p> | <p>Parashihet forcimi dhe zgjerimi përmbajtësor i kompetencave të njësive lokale të vetëqeverisjes, në përputhje me Kartën Europiane për Vetëqeverisje Lokale, në fushën financave lokale. Po ashtu, parashihen procedura speciale parlamentare, ku kërkohet shumica e votave të numrit total të përfaqësuesve që pretendojnë se u takojnë komuniteteve joshumicë (2/3), edhe për ndryshimin e ligjeve për financa lokale.</p> | <p>Vojvodina duhet me pasë burime të drejtpërdrejta të të ardhurave për financimin e aktiviteteve në kuadër të kompetencave që ka. Përveç që buxheti i Vojvodinës duhet me marrë të paktën 7% të buxhetit të Sërbisë, Vojvodina duhet t'i sigurojë të ardhurat e veta edhe përmes: mbledhjes së taksave, të ardhurave vjetore nga prona kur është titullare e saj, pjesëmarrjes në të ardhura të ndërmarrjeve publike dhe institucioneve, kredive publike, komerciale, bartjes së resurseve buxhetore, të donacioneve e granteve dhe të burimeve tjera.</p> | <p>Rajoni financohet nga të ardhurat nga tatimi në pronën që gjendet në territorin e rajonit, por i takojnë edhe këto kuota: 9/10 nga tatimet mbi trashëgiminë dhe donacionet; 2/10 e tatimit të përgjithshëm mbi të ardhurat në shkallë rajonale; dhe 90% e të ardhurave nga lotaria; krahinat financohen nga të ardhurat prej tatimit mbi shpenzimin e gazit dhe të energjisë që mbliidhen në krahina. Po ashtu, 90% e tatimit mbi të ardhurat të grumbulluara në territoret e krahinave u takon krahinave.</p> | <p>Financimi i Katalonisë, sikurse edhe i komuniteteve tjera autonome, bëhet përmes të tatimet që mbledhen në territorin e Katalonisë si tatimi në të ardhura, tatime prej të cilave Spanja heqë dorë totalisht dhe tatime prej të cilave heqë dorë pjesërisht, sikurse edhe të drejtën e financimit shtesë nga mjetet e ndara nga buxheti i Republikës së Sërbisë. e kështu me radhë.</p> |     |



## Polici

| Kosova   | Maqedonia   | Serbia (Vojvodina)  | Italia   | Spanja  | PPS |
|--|---|---|--|---|-----|
| <p>Komunitetet kanë të drejtë për përfaqësim të barabartë proporcional në punësim në sektorin e policisë në zonat e banuara me komunitetin përkatës, duke respektuar rregullat që kanë të bëjnë me kompetencën.</p> <p>Komunat ku komuniteti sërb është shumicë kanë të drejta të avancuara pjesëmarrëse në zgjedhjen e komandantëve të stacioneve policore, duke propozuar së paku dy emra për komandantë stacioni, njërin prej të cilëve duhet ta emërojë Ministria e Punëve të Brendshme.</p> <p>Në nivel të Kosovës ruhet zinxhiri i unifikuar i komandës së policisë.</p> | <p>Shefat lokalë të policisë zgjedhen nga këshillat komunale, por nga lista e kandidatëve të propozuar nga Ministria e Brendshme, e cila e mbanë të drejtën për t'i shkarkuar ata në përputhje me ligjin. Kjo listë nuk duhet të ketë më pak se tre kandidatë, një prej të cilëve të paktën duhet të jetë prej komunitetit shumicë në komunë. Shërbimet policore do të reflektojnë përgjithësisht përbërjen dhe shpërndarjen e popullatës. Për këtë do të sigurohen 500 zyrtarë të rinj policorë nga komunitetet jo shumicë të cilët do të vendosen në vendet ku jetojnë këto komunitete.</p> | <p>Kushtetuta e Italisë, e edhe Statuti i Tirolit të Jugut e precizojnë se rajonet kanë të drejtë të nxjerrin ligje për policinë urbane dhe rurale.</p> <p>Forca policore lokale e Krahinës Bolzano kryen aktivitetet të patrullimit të trafikut rrugor, menaxhim të tiketave dhe çështje legale.</p> | <p>Në çështjet e sigurisë publike, në përputhje me legjislacionin shtetëror, Katalonia është përgjegjëse për planifikim dhe rregullim të sistemit të sigurisë publike, organizim të policisë lokale, krijim dhe organizim të Forcës Policore mbi të cilën ka komandë supreme dhe koordinon aktivitetet e policisë lokale.</p> <p>Po ashtu, Forca Policore ka përgjegjësi edhe për kontroll të trafikut dhe ushtron të gjitha funksionet në siguri e rend publik dhe hetim të krimit të organizuar e terrorizmit. Duhet thënë edhe se Katalonia në bashkëpunim me shtetin koordinon politikat e sigurisë.</p> | <p>Policia Autonome mund të themelohet sipas modelit të policisë autonome të Katalonisë dhe përgjegjësi të ngjashme. Ajo do të ishte, në kuptimin formal, pjesë e Forcave Policore të Kosovës, edhe pse do të funksiononte nën autoritetin e Këshillit Ekzekutiv të Bashkësisë së Komunave Sërbe të Kosovës dhe Metohisë.</p> |     |

## Religion

| Kosova  | Maqedonia   | Serbia (Vojvodina)  | Italia        | Spanja   | PPS  |
|---|---|---|---------------|--|--|
| <p>Kosova ka detyrë të sigurojë mbrojtje të veçantë tërësive të objekteve dhe monumenteve kulturore e fetare të komunitetit serb. Kosova e njëj Kishën Ortodokse Serbe (KOS) në Kosovë si pjesë integrale e KOS-it me seli në Beograd dhe i ofron siguri shtesë dhe masa të tjera mbrojtëse. Autoritetet e Kosovës kanë qasje në këtë pronë vetëm me pëlqimin nga Kisha ose në rastet kur lëshohet urdhër gjyqësor në lidhje me aktivitetet joligjore. KOS në Kosovë mund të pranojë donacione nga çdo institucion brenda ose jashtë Kosovës, por në mënyrë të hapur. Kosova i ofron KOS-it në Kosovë privilegje doganore dhe tatimore.</p> | <p>Marrëveshja garanton lirinë dhe të drejtën për me e shprehë besimin lirish e publikisht, dhe individualisht ose me të tjerët. Komunitetet religjioze, Kisha Ortodokse Maqedone, Komuniteti Religjioz Islamik dhe Kisha Katolike, sipas kësaj marrëveshjeje, janë të ndara prej shtetit, të barabarta para ligjit dhe të lira për të themelua shkolla dhe institucione të tjera shoqërore e bamirëse, të rregulluara me ligj.</p> | <p>Vojvodina synon, mes tjerash, promovimin e parimit të multikonfesionalizmit. Të gjithë mekanizmat krahinorë kanë për obligim të mbështesin familjarizimin me religjione të ndryshme në Vojvodinë. Vojvodina ka kompetenca të bashkëpunojë me kishat dhe komunitetet religjioze në territorin e krahinës.</p> | <p>Nuk ka</p> | <p>Katalonia ka kompetenca ekskluzive sa i takon entiteteve religjioze që kryejnë aktivitetet e tyre në Kataloni, e kjo nënkupton rregullimin dhe vendosjen e bashkëpunimit dhe mekanizmave bashkëpunues për të kryer aktivitetet e tyre. Katalonia mund të vendosë marrëveshje bashkëpunimi me komunitetet religjioze, por edhe ka për detyrë që të promovojë, zhvillojë dhe ekzekutojë marrëveshjet e nënshtruara mes Spanjës dhe kishave dhe komuniteteve religjioze të regjistruara.</p> | <p>Të vendoset një marrëdhënie speciale kontraktuale mes kishës ortodokse serbe dhe institucioneve të Kosovës dhe të jepet një garanci e vlefshme ndërkombëtarisht në lidhje me premtimet që i bëhen kishës ortodokse serbe, pronës kishitare dhe aktivitetit të kishës ortodokse serbe në territorin e Kosovës.</p> |

## Gjyqësi

| Kosova   | Maqedonia  | Serbia (Vojvodina)  | Italia  | Spanja  | PPS  |
|--|--|---|---|---|--|
| <p>Së paku 15% e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, jo më pak se 3, vijnë nga komunitetet jo shumicë dhe së paku 15% e gjyqtarëve të secilës gjykatë të qarkut, jo më pak se 2, vijnë nga komunitetet jo shumicë. Komuna me shumicë prej komuniteteve jo shumicë të Kosovës, mund ta parqet kërkesën para Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për themelimin të gjykatës themelore ose që gjykata nga komuna tjetër të ketë juridiksion mbi komunën që nuk ka gjykatë themelore. Nëse KGJK refuzon këtë kërkesë, atëherë themelohen zyre ndërlidhëse, ose gjykata themelore mbanë seancat në territorin e komunës që nuk ka gjykatë. KGJK i jep përparësi pjesëtarëve të komuniteteve të nën-përfaqësuar deri atëherë kur përqindja e gjyqtarëve dhe prokurorëve pjesëtarë të komuniteteve serb në Kosovë të jetë nën 8% dhe/ose atyre të komuniteteve jo shumicë të jetë nën 15%. KGJK do të përbëhet nga 13 anëtarë, ku dy prej tyre do t'i zgjedhin deputetët që mbajnë ulëset e rezervuara për komunitetin serb të Kosovës, 2 do t'i zgjedhin deputetët që mbajnë ulëset e rezervuara për përfaqësuesit e komuniteteve tjera, dhe 2 do t'i zgjedhin deputetët që mbajnë ulëset e fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të ulëseve.</p> | <p>Marrëveshja parashihet procedura speciale parlamentare, ku kërkohet shumica e votave të numrit total të përfaqësuesve që pretendojnë se u takojnë komuniteteve joshumicë (2/3), për të zgjedhë: një të tretën e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese; tre prej anëtarëve të Këshillit Gjyqësor.</p> | <p>Elkziston Gjykata Rajonale Administrative me degët autonome për krahinën Bolcano, anëtarët e të cilës duhet t'u takojnë me numër të barabartë të dy bashkësisë kryesore gjuhësore. Personat që dëshirojnë të emërohen për gjyqtarë, zëvendës të gjyqtarëve, ndihmës dhe praktikantë, si dhe për udhëheqës të kancelarëve, duhet të flasin italisht dhe gjermanisht shkëlqyeshëm.</p> | <p>Gjykata Supreme e Drejtësisë e Katalonisë është trupi suprem juridik, kompetent në fushat e të drejtës civile, penale, administrative dhe juridike dhe mbron të drejtat e njohura me Statutin e Katalonisë. Kjo gjykatë ka autoritet ekskluziv për të interpretuar ligjin në Kataloni. Presidenti i kësaj gjykate është përfaqësues i pushtetit juridik në Kataloni, nominohet nga Mbreti, në bazë të propozimit të Këshillit të Përgjithshëm të Pushtetit Gjyqësor dhe me pjesëmarrje të Këshillit të Drejtësisë të Katalonisë. Po ashtu, Gjykata Supreme e Drejtësisë e Katalonisë ka Prokurorin Publik, që është prokuror suprem.</p> | <p>Gjykata Supreme e Drejtësisë e Katalonisë është trupi suprem juridik, kompetent në fushat e të drejtës civile, penale, administrative dhe juridike dhe mbron të drejtat e njohura me Statutin e Katalonisë. Kjo gjykatë ka autoritet ekskluziv për të interpretuar ligjin në Kataloni. Presidenti i kësaj gjykate është përfaqësues i pushtetit juridik në Kataloni, nominohet nga Mbreti, në bazë të propozimit të Këshillit të Përgjithshëm të Pushtetit Gjyqësor dhe me pjesëmarrje të Këshillit të Drejtësisë të Katalonisë. Po ashtu, Gjykata Supreme e Drejtësisë e Katalonisë ka Prokurorin Publik, që është prokuror suprem.</p> | <p>Ligjet duhet të parashohin një mekanizëm me të cilin qytetarët e Bashkësisë së Komunave Serbe, përmes përfaqësuesve të tyre mund të ndikojnë në zgjedhjen dhe përbërjen e gjykatave. Gjykata do të kenë autoritetin në rajonin Bashkësisë së Komunave Serbe për të vendosur në të gjitha çështjet gjyqësore që ndërlidhen me marrëdhëniet bazike personale, të drejtat dhe detyrat e qytetarëve, të shpallin dënime dhe masat tjera kundër kryesve të veprave kriminale dhe veprave tjera të dënueshme të përcaktuara me ligj; për të vendosur rreth ligjshmërisë së akteve individuale të organeve dhe organizatave që ushtrojnë autoritet publik; të vendosin rastet e ndërlidhura me çështjet pronësore apo çështje të ligjit të punës dhe të vendosin rreth çështjeve të tjera në pajtim me ligjet në fuqi.</p> |

## Institucionet politike

|  | Kosova  | Maqedonia     | Serbia (Vojvodina)  | Italia   | Spanja  | PPS   |
|--|---|---------------|---|--|---|---|
|  | <p>Komunat me shumicë sërbe kanë të drejtë të krijojnë partneritet mes vete për zbatimin e përgjegjësiwe komunale dhe kompetencave të zgjeruara, inter alia, përmes: themelimit të një organi vendimmarrës me përfaqësues të komunave pjesëmarrëse. Partneriteti ka të drejtë për marrëdhënie të drejtpërdrejta me institucionet në Sërbë vetëm deri në masën e nevojshme për zbatimin e aktiviteteve të partneritetit. Vendimet dhe aktivitetet e partneritetit duhet t'u nënshtrohen kërkesave për raportim te autoriteti kompetent qendror, si dhe shqyrtimit administrativ për pajtueshmëri me legjislacionin. Komunat e angazhuara në partneritet duhet të publikojnë informatat për aktivitetet dhe buxhetin e partneritetit.</p> | <p>Nuk ka</p> | <p>Vojvodina ka status të entitetit legal dhe ka institucione legjislative e ekzekutive: Kuvendin që mund të ndërmarrë aktivitete në kuadër të kompetencave që ka krahina, si dhe Qeverinë e cila është ekzekutive e vendimeve të Kuvendit.</p> | <p>Organet Rajonale janë: Këshilli Rajonal me kompetenca legjislative; Këshilli Ekzekutiv Rajonal, që është trup ekzekutiv për zbatimin e ligjeve në rajon; dhe Kryetari i Këshillit Ekzekutiv, i cili e përfaqëson Rajonin.</p> | <p>Generalitat përbëhet nga Parlamenti, Presidenca dhe Qeveria. Parlamenti përfaqëson qytetarët e Katalonisë dhe ushtron pushtet legjislativ, miraton buxhetin dhe kontrollon e promovon veprimet politike e qeveritare. Parlamenti ka autonomi organizative, financiare dhe administrative dhe cakton senatorët që përfaqësojnë Kataloninë në Senat, të cilët duhet të jenë në proporcion me numrin e anëtarëve të secilit grup parlamentar. Presidenti është përfaqësuesi më i lartë i Generalitiat dhe drejtues i veprimeve të Qeverisë. Presidenti caktohet nga Mbreti dhe zgjedhet nga Parlamenti. Në emër të Mbretit ai ka kompetenca, mes tjerash, për të aprovuar ligjet. Qeveria ushtron funksione ekzekutive në përputhje me Statutin e Katalonisë dhe Kushtetutën e Spanjës dhe përbëhet nga Presidenti, Ministri i Parë (i cili caktohet nga Presidenti) dhe ministrat.</p> | <p>Bashkësia e Komunave Sërbe të Kosovës dhe Metohisë do të ketë një Asamble dhe një Këshill Ekzekutiv që do të jenë të ngarkuar me zbatimin e detyrave nga përkufizimi i përgjegjësiwe</p> |

## Marrëdhëniet me jashtë

|  | Kosova  | Maqedonia | Serbia<br>(Vojvodina)   | Italia   | Spanja  | PPS           |
|--|---|-----------|---|--|---|---------------|
|  | <p>Nuk ka të drejtë për marrëdhënie me jashtë, por ka të drejtë për marrëdhënie me Sërbinë disa fusha, si arsimi, financat, religjioni, e me radhë.</p> |           | <p>Vojvodina ka të drejtë të bashkëpunojë me komunitetet territoriale dhe format e tjera të autonomive në vendet e tjera në kuadër të politikës së jashtme të Republikës së Sërbisë dhe të bëjë marrëveshje ndër-regjionale në fushat që janë kompetencë e saj, duke pasqyruar integritetin territorial dhe sistemin legal të Sërbisë. Vojvodina mund të themelojë zyrat përfaqësuese në regjionet europiane për t'i promovuar kapacitetet në ekonomi, shkencë, edukim dhe turizëm dhe të jetë anëtare e asociacioneve europiane dhe ndërkombëtare të regjioneve.</p> | <p>Vetëm Qeveria e Italisë mund të hyjë në marrëveshje ndërkombëtare, por Kushtetuta e Italisë parashihet që regjionet mund të kryejnë “aktivitete promovuese”, për shembull në fushën e turizmit, me qeveritë e huaja, por jo të marrin obligime ndërkombëtare.</p> | <p>Për të promovuar interesat e Katalonisë, Generalitat ka të drejtë të themelojë zyra jashtë vendit dhe të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi në fushat që janë kompetencë e saj. Sa i takon marrëveshjeve ndërkombëtare Spanja duhet ta informojë Kataloninë paraprakisht nëse ato marrëveshje kanë efekt të drejtpërdrejtë në kompetencat e Katalonisë. Po ashtu, Katalonia ka të drejtë për bashkëpunim tej-kufitar dhe ndër-regjional.</p> | <p>Nuk ka</p> |

## Procedurat speciale parlamentare

|  | Kosova  | Maqedonia  | Serbia (Vojvodina) | Italia        | Spanja        | PPS           |
|--|---|--|--------------------|---------------|---------------|---------------|
|  | <p>Pa votat e shumicës së deputetëve të komuniteteve joshumicë, nuk mund të miratohen, ndryshohen a shfuqizohen: ligjet që ndryshojnë kufijtë komunalë, themelojnë ose shuajnë komunat, përcaktojnë shtrirjen e pushteteve të komunave dhe pjesëmarrjen e tyre në marrëdhëniet ndërkomunale e tejkufitare; ligjet që implementojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, përveç atyre të përcaktuara me kushtetutë; ligjet për përdorimin e gjuhëve; për zgjedhjet lokale; për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore; për lirinë fetare ose për marrëveshjet me komunitetet fetare; për arsimin; për përdorimin e simboleve (përfshirë simbolet e komunitetit) dhe festat publike. Dhjetë a më shumë deputetë të Kuvendit, mes tjerash, kanë të drejtën që të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji a vendimi të miratuar nga Kuvendi pranë Gjykatës Kushtetuese (në aspektin përmbajtësor dhe procedural). Për çdo ndryshim të Kushtetutës kërkohet miratimi i dy të tretave të deputetëve që mbajnë vende të rezervuara për komunitetet jo shumicë në Kosovë.</p> | <p>Marrëveshja parashihet procedura speciale parlamentare, ku kërkohet shumica e votave të numrit total të përfaqësuesve që pretendojnë se u takojnë komuniteteve joshumicë (2/3), për të zgjedhë: një të tretën e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese; tre prej anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, dhe Ombudspersonin. Kjo shumicë nevojitet edhe për ndryshimin e disa amendamenteve kushtetuese dhe të vetëqeverisjes lokale në: kulturë, përdorim të gjuhës, edukim, dokumentacion personal, përdorim të simboleve, ligje për financa lokale, për zgjedhje lokale, për qytetin e Shkupit dhe për kufijtë e komunave, rishikimi i të cilave parashihej me ndodhë pas regjistrimit të popullsisë.</p> | <p>Nuk ka</p>      | <p>Nuk ka</p> | <p>Nuk ka</p> | <p>Nuk ka</p> |

## Mekanizma për përfaqësim special

|  | Kosova   | Maqedonia  | Serbia (Vojvodina) | Italia | Spanja | PPS           |
|--|--|--|--------------------|--------|--------|---------------|
|  | <p>20 ulëse janë të rezervuara për përfaqësim të komuniteteve joshumicë në Kosovë: 10 për komunitetin serb dhe 10 për komunitetet tjera, kurse çdo ulëse e ftuar përmes zgjedhjeve do të jetë ulëse shtesë. Deputetët e komunitetit serb do të kenë: së paku një përfaqësues në Kryesinë e Kuvendit; së paku një zëvendëskryesues në secilin komision parlamentar do të jetë nga komuniteti tjetër prej atij që i përket kryesuesi; së paku një ministër dhe dy zëvendësministra do të jenë nga komuniteti serb. Në komunat në të cilat së paku 10% e banorëve i përkasin komuniteteve joshumicë, posti i zëvendëskryetarit për komunitete rezervohet për një përfaqësues të komuniteteve, kurse posti tjetër i zëvendëskryetarit do të mbahet nga kandidati që i përket popullatës joshumicë që ka marrë shumicën e votave.</p> | <p>Pjesëmarrja e një partie shqiptare në Qeveri, parim në nivel të përkushtimit, por jo detyrimit kushtetues</p> |                    |        |        | <p>Nuk ka</p> |





